# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7675 E mërkurë 10 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)










Opinioni i Ditës

Nga ANDI BUSHATI

## "Babalja", ku u xhirua filmi, në SHQUP apo në Surrel?



Botimi i një pjese nga raporti i ekspertizës angleze të "JP French Associates" nuk ka vërtetuar dot as që përgjimi i "Babales" ishte i besueshëm ...

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga JULIAN ZYLA

## Komunikimi kundër opozitës i opozitës

Kritikat ndaj qeverisë kanë qenë nga më kreativet dhe të lirshmet ndaj një qeverie në Shqipëri, si nga opozita ashtu dhe nga shoqëria civile. Atëherë, kur ...

Vijon në faqen 21




"Ervis Matën e kam takuar rastësisht"

# "Me Fabin vritesha edhe për një shikim", dëshmia e plotë e Ervis Martinajt

Rrëfimi në gjyq: Këngëtarja s'ka lidhje fare. Po të mos ndërhyja unë, "Kokëmadhi" do të kishte vdekur, u tregua legen që qëlloi

TRENDAFILE VISHA

TIRANË- Këngëtarja e njohur Elvana Gjata, e cilësuar si "mollë sherri" për masakrën e ndodhur mbrëmjen e 4 tetorit në lokalin "Monopol", ku mbeti ...

Në faqen 9

KRYEMINISTRI PARALAJMERON MBYLLJEN E MBI 5 MIJE SUBJEKTEVE NE VEND

# RAMA: BRENDA VITIT, DRY TE GJITHA KAZINOVE E LOTOVE

Vendimi, që nga 1 janari 2019 s'ka më baste sportive dhe lojëra elektronike në qytete. Rama: Ja pse nuk ia japim Serbisë Telekom Albanian



(Në foto) Kryeministri, Edi Rama, duke folur gjatë një konference shtypi pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave

Në faqen 7

PERPLASJA PS-PD

## Rama: Konspiracion ndaj qeverisë. Basha: Tahiri-Mata bashkë në Gjermani

Në faqen 5

INTEGRIMI EUROPIAN

## PE-ja, pa datë për negociatat e Shqipërisë: Përmbushni kushtet

Në faqen 6

16 TE SHOQERUAR

## Shpërthimi me tritol, merret në ruajtje shtëpia e Xhisiela Malokut

Në faqen 8

LISTA EMERORE



## Provimi i shtetit, kandidatët për infermieri, mami dhe fizioterapi

Në faqet 10-12

Vendimi i gjykatës: Audiopërgjimi u sajua për të deniguar Fatmir Xhafajn

# Kunati i "Babales": E inskenuam për 200 mijë euro

*Përgjimet, Alfred Alizoti: Salianji ja premtoi paratë Albert Veliut*

Në dosjen e prokurorisë për rastin "Babalja" gjenden përgji-met që janë kryer në numrat telefonikë të Fredi Alizotit, Albert Veliut dhe disa personave të tjerë më të cilët këta komunikonin, ku bëhet e qartë biseda rreth inskenimit të audio-përgjimit. Ka qenë Alizoti (kunati i Babales) ai që





pranon në disa biseda se rolin e Agron Xhafajt në përgjim e ka luajtur ai dhe se i janë premtuar 100 mijë euro për këtë rol. Madje, në disa biseda, ai tregon se ato para nuk i ka marrë, por Veliu, sipas tij, ka marrë 70 mijë euro përpara se të nisej për në ...

Në faqet 2-3

EMRAT

## Legalizimet, 160 familjet që marrin lejet në kryeqytet

Në faqen 17

# DOSJA "BABALJA"

## VENDIMI

Kunati i "dëshmitarit X" shkoi vetë në prokurori: Bëra sikur isha vëllai i Xhafajt

# Fredi Alizoti: Unë bëra zërin e Agronit, Salianji i premtoi Babales 200 mijë euro

## Përgjimet: Jan fals ato o vlla, mori Berti 70 mijë e iku




Në dosjen e prokurorisë për rastin "Babalja" gjenden përgjimet që janë kryer në numrat telefonikë të Fredi Alizotit, Albert Veliut dhe disa personave të tjerë më të cilët këta komunikonin, ku bëhet e qartë biseda rreth inskenimit të audio-përgjimit.

Ka qenë Alizoti (kunati i Babales) ai që pranon në disa biseda se rolin e Agron Xhafajt në përgjim e ka luajtur ai dhe se i janë premtuar 100 mijë euro për këtë rol. Madje, në disa biseda, ai tregon se ato para nuk i ka marrë, por Veliu, sipas tij, ka marrë 70 mijë euro përpara se të nisej për në Kosovë. Në përgjimet e zbardhura nga "Panorama online" janë edhe dy biseda interesante mes tij dhe "Babales", ku Alizoti i kërkon atij që të kërkojë shumën e premtuar. Gjithashtu, interesant është fakti se ka qenë Alizoti që nuk ka duruar më dhe ka telefonuar në policinë e Fierit, duke treguar gjithçka, përpara se të drejtohej në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ku ka folur për audio-përgjimin dhe se si u realizua ai.


Fredi Alizoti

### PËRGJIMET

Në datë 01.06.2018 i janë marrë deklarime shtetasit Fredi Elmaz Alizoti. Komunikimet telefonike të këtij shtetasi kanë qenë në përgjim me vendim të prokurorit të datës 22.05.2018, të vlerësuara me vendimin e Gjykatës nr. 457 datë 24.05.2018. Ky shtetas ka deklaruar që rreth orës 16:00, të datës 01.06.2018, kishte kërkuar të komunikonte me Drejtorinë e Policisë Fier, pasi donte të deklaronte disa fakte. Kishte kontaktuar me drejtorin, i cili e kishte orientuar që të jepte deklarime në Prokurorinë për Krime të Rënda. Ky shtetas ka deklaruar që shtetasin Albert Veliu (Babalja) e njihte prej 20 vitesh. Rreth muajve tetor-nëntor të vitit 2017, ai kishte thënë që donte t'i bënte një regjistrim shtetasit Agron Xhafaj, vëllai i ministrit të Brendshëm, por nuk i gjente dot anën, pasi nuk e afronte. I kishte ofruar që të bënin një regjistrim, shtetasi Fredi të hiqej sikur ishte shtetasi Agron Xhafaj. Për këtë shërbim, "Babalja" i kishte thënë që do të merrnin 200 mijë euro nga deputeti me mbiemrin Salianji. Këtë bisedë e kishin regjistruar në Vlorë te një lokal përballë atij që kishte shtetasi Agron Xhafaj. Sipas deklaruesit, "Babalja" kishte premtuar që do t'i jepte 100 mijë euro dhe zëri i shfaqur në regjistrimin e bërë publik nga televizionet në bisedë me "Babalen" ishte zëri i tij. "Babalja" deri në këto momente nuk i ka dhënë asnjë lekë.

Në datë 27.09.2018, i janë marrë deklarime shtetasit Fredi Alizoti në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, në praninë e mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Ai u ka qëndruar deklarimeve të dhëna në datën 01.06.2018. Përgjimi ishte kryer me një mjet stilolaps, kishte qenë vetëm me Albertin. Nuk mbante mend periudhën e saktë, por mund të ketë qenë në janar të vitit 2018, ku kanë regjistruar bisedën. Kohë para kryerjes së regjistrimit, Alberti i kishte thënë të bënin një regjistrim bisede ku Fredi do hiqej sikur ishte shtetasi Agron Xhafaj.

Këtë gjë do e bënin kundrejt një shpërblimi 200 mijë eurosh, që do e ndanin përgjysmë. Këto para do ia jepte Ervin Salianji, "Babales" kur biseda të shfaqej në televizion. Në kuadër të hetimeve të këtij procedimi është vendosur lejimi i përgjimit të komunikimeve të disa numrave telefonikë. Nga procesverbalet e transkriptimeve ka rezultuar: - Në datë 20.05.2018, ora 09:25, përdoruesi i nr. të tel *****599 (Albert Veliu) telefonon përdoruesin me nr. tel. ****770 dhe bëjnë këtë bisedë:

Veliu: Ku do e pimë një kafe?

770: Të thashë dhe dje, do të marrim vetë…

Veliu: O vlla, unë jam në mes të katër rrugëve, në rregull, s'kam çfarë pres më tani vllai jot, se jam shumë i stresuar dhe i lodhur. Ka edhe të tjerë për lart e për poshtë, s'dua të flas në telefon. Ka mundësi të takohesh 5 minuta…

-Në datë 20.05/2018, ora 19:55 përdoruesi i nr. të tel ****692 Albert Veliu, telefonon përdoruesin me nr. ****327 dhe bëjnë këtë bisedë:

Veliu: E më thuaj se tani po ulem po flas me lart, mos flas shumë unë, ça të thanë ata zotërinjtë ty?

327: Ata zotërinjtë ishin anë shoqërore e juaja nga ana e atij tjetrit?

Veliu: Po e atij shokut tim, po shokut tim nga Vlora, po vazhdo.

327: Bravo, vetëm njëri nga ata, edhe erdhën dy edhe thanë, ne kemi si urdhër që ik e gjejuni një shtëpi një muaj tha, pastaj gjëra të tjera jo.

Veliu: Gjëra të tjera s'bëjnë asnjë gjë ata, vetëm shtëpi një muaj? Kaq të tha?

327: Po, po, po, pastaj ne nuk dimë, tha se as njëri as tjetri nuk kanë sqaruar asnjë gjë…

Veliu: Ka dhënë urdhër dikush të vijnë t'ju marrin, t'ju sistemojnë e të gjitha ça të duan, kshu është puna.

327: T'ia them hapur atyre?

Veliu: Po më kanë dërguar thuaj, e di vetë ti, emrin E-ja me L-në.

327: Nuk e di Berti, na e shkruaj me mesazh.

Veliu: L-ja është ai i madhi, krushku im. E-ja është ai poshtë.

327: Shkruaji një mesazh Ledios (Jetmir Olldashit) të na e shkruajë ne.

Veliu: L, si Luli jot shoqje.

327: Puna është nuk duhet të flas unë, të flasin ata gojarisht dhe ata të jenë se unë kur ika, ika me urdhër.

Veliu: Mos fol shumë në telefon, Luli me Ervinin kaq e di vetë ai.

327: Kush?

Veliu: Luli me Ervinin, kaq…

-Në datë 29.05.2018, ora 21:00, përdoruesi i numrit telefonik ****000 i telefonon përdoruesit të numrit telefonik *****091 (Fredi Alizoti) dhe gjatë bisedës u fol për premtimin që duhet të mbante dikush që e kishte dhënë atë.

000: Unë nuk kam dit gjo fare, as u kam thon hajeni, as hiç, por ai që ju ka premtue, ça u ka than, duhet t'u rri tek kamt e me ja marr.

Alizoti: Nuk kemi marrë asgjë akoma, po do llafosemi, do pimë kafe dhe do të të sqaroj unë. Jo me se më premtun diçka këtu, prit eee, kupton ti. Çunat po e mbajnë nga brenda se thesin e kam unë, po ta hap unë thesin mbaron çdo gjë… e kupton vetë ti muhabetin.

000: Nëse i ka hy për lek, ka bo gabimin më të madh, e mo, shoku jem, po ça boni, o burrë.

Alizoti: …unë prap po rri fisnik. Ato që janë premtuar… nuk kam marrë asgjë… dhe unë një llaf tani dhe përmbyset bota, kthehet nga e para e del çdo gjë falso… kupton. Janë falso, janë falso, po ta them me shpirt.

000: Eni pra, mos u bini në qafë njerëzve kur janë falso, mos u bini në qafë njerëzve kot, o vlla… Atë ditë takova rastësisht Babalen dhe i thashë… vetja i thashë, ke hi i merr në qafë robt kot. Me i bo letrat për azil, nuk e di si i boni kto punë.

Alizoti: Është e vërtetë kjo vllai, është e vërtetë.

-Në datë 01.06.2018, ora 16:40, përdoruesi i numrit telefonik ****091 (Alizoti) i telefonon nr. 129 (Policisë) dhe bën këtë bisedë:

Alizoti: Dëgjo mua, dëgjo mua një sekondë, do më dëgjosh me vëmendje, a më dëgjon?

129: Po ju dëgjoj zotëri, fol.

Alizoti: Ajo dëshmi e Babales është falso dhe unë jam ai origjinali.

129: Mirë, mirë, ja po të merr drejtori në telefon tani, lëre atë e di unë…

-Në datë 01.06.2018, ora 16:52, përdoruesi i numrit telefonik ****3316 i telefonon numrit ***091, Alfred Alizoti. Midis tyre ishin realizuar disa komunikime ku i kërkohet drejtuesit të Policisë së Qarkut Fier që posedon numrin e parë, që do t'i komunikohej diçka shumë e rëndësishme dhe zhvilluan bisedën si më poshtë:

Alizoti: Ajo që është bërë mes telefonatave dhe përgjimi, kam qenë unë që e kam bërë atë… Ai që është bërë në përgjime… ajo që është bërë me Babalen në përgjime… kam qenë unë që e kam bërë.

Drejtuesi i Policisë Fier: Me kë ke qenë kur e ke bërë?

Alizoti: Me Babalen, me asnjëri tjetër.

Drejtuesi i Policisë Fier: Nuk ke qenë ti bashkë me Agronin?

Alizoti: Jo, jo, ka qenë Babalja, unë kam qenë në vend të Agronit.

Drejtuesi i Policisë Fier: Je i sigurt për këtë?

Alizoti: Jam i sigurt, më dëgjo mua, do më dëgjosh me vëmendje, më dëgjo mua dhe do të të flisja me fakte… na premtuan 200 mijë euro, unë s'kam marrë asgjë, i mori Berti 70 mijë euro dhe iku, e kupton. Jam i sigurt dhe me dorë në zjarr.

-Më datë 06.06.2018, ora 21:33, përdoruesi i numrit telefonik ****091 Alfred Alizoti telefonohet nga numri *****272, dyshohet si Albert Veliu dhe zhvillojnë këtë bisedë:

Alizoti: E takova, jo ktej, jo andej, jam keq, po dridhej. Veliu: Ore, ➔

**EKSPERTIZA**

Kompania që ka realizuar ekspertimin teknik të audio-përgjimit të "Babales" është kompania "JP French Associates" në Britaninë e Madhe. Sipas kësaj akt-ekspertize regjistrimet nuk janë origjinale. Materiali që i është vënë në dispozicion është një regjistrim video që është marrë nga pamjet e mediave dhe joorigjinal.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Zbardhet vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda për rastin "Agron Xhafaj"

# Prokuroria: Donte azil familjar, ja pse "Babalja" inskenoi përgjimin e rremë

## *Gazetari donte të denigronte Fatmir Xhafajn*

Klodiana Lala

Zbardhet vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda për çështjen 'Babalja'. Në vendimin e gjykatës të siguruar nga gazetarja Klodiana Lala për 'BalkanWeb' pasqyrohen dëshmitë e Fredi Alizotit, për të cilën u kërkua nga prokuroria masa 'arrest me burg', masë që u caktua edhe për Albert Veliun.

Ky i fundit është cilësuar si 'dëshmitari X', në audiopërgjimin e publikuar nga PD, ku implikohet vëllai i ministrit Xhafaj, Agron Xhafaj në pazare droge.

Në vendimin e zbardhur thuhet se Jetmir Olldashi nuk dorëzoi përgjimin origjinal, ndërkohë që motivet që i shtynë të hetuarit për 'kallëzim të rremë' janë të ndryshme. Sipas vendimit të gjykatës, motivi i Olldashit lidhet me denigrimin e figurës së ministrit Xhafaj, ndërsa Veliu kërkonte të përfitonte azil për vete dhe familjarët.

"Motivet që i shtynë të hetuarit në kryerjen e veprës penale të 'kallëzimit të rremë' rezultojnë të ndryshëm. Për të hetuarin Olldashi me profesion gazetar dhe me lidhje të ngushta të një prej deputetëve të krahut opozitar, dyshohet se motivi lidhet me denigrimin e figurës së ministrit të Brendshëm. Qëllimi i investigimit të tij, sikurse iu pohoi drejtuesit të emisioni të 'Pa Ekspozuarit' ishte vëllai i ministrit të Rendit, ndërsa materiali i përgjuar nëse do ishte i vërtetë, do të duhej ta dorëzonte në organet e ndjekjes penale dhe jo në selinë e një force politike. Për të hetuarin Veliu, motivi dyshohet se lidhet me qëllimin për të përfituar për vete dhe për familjarët azil", thuhet në një pjesë të vendimit.

Po ashtu në vendimin e gjykatës thuhet se tre të pandehurit realizuan inskenimin, ndërsa pas dështimit shkruhet se ata përdorën Fredi Alizotin. Sipas vendimit të Krimeve të Rënda, Alizoti ka me ngjashmëri zëri me Agron Xhafajn.

**AKT-EKSPERTIZA BRITANIKE**

Ekspertes britanike që analizoi materialin audio të përgjimit të vëllait të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, do t'i duhej një cilësi më e mirë e të folurës së personit që pretendohet se ishte shtetasi Agron (Geron) Xhafaj për të dhënë një konkluzion të qartë nëse ka qenë i përfshirë në bisedën me shtetasin Albert Veliu, të njohur ndryshe si "Babalja".

Sipas përgjimeve, që janë kryer në numrat telefonikë të Fredi Alizotit, Albert Veliut dhe disa personave të tjerë më të cilët këta komunikonin, bëhet e qartë biseda rreth inskenimit të audio-përgjimit.



Gjykata e Krimeve të Rënda

Ka qenë Alizoti ai që pranon në disa biseda se rolin e Agron Xhafajt në përgjim e ka luajtur ai dhe se i janë premtuar 100 mijë euro për këtë rol. Madje, në disa biseda, ai tregon se ato para nuk i ka marrë, por Veliu, sipas tij, ka marrë 70 mijë euro përpara se të nisej për në Kosovë. Në përgjime janë edhe dy biseda interesante mes tij dhe "Babales", ku Alizoti i kërkon atij që të kërkojë shumën e premtuar. Gjithashtu, interesant është fakti se ka qenë Alizoti që nuk ka duruar më dhe ka telefonuar në Policinë e Fierit, duke treguar gjithçka, përpara se të drejtohej në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ku ka folur për audio-përgjimin dhe se si u realizua ai.

**PROKURORIA**

"Për të hetuarin Veliu, motivi dyshohet se lidhet me qëllimin për të përfituar për vete dhe për familjarët azil",- thuhet në një pjesë të vendimit.

← thuaj bëj likuidimin që kemi lënë, thuaj kaq, asgjë në botë o Fredi vllai se me atë s'kam lidhje fare kontakti, besomë se jam në azil, për shpirt të plakës, unë flas me anë të tjetrit, me kosovarin, me atë. Thuaj e vlla, bëj likuidimin si e lamë, thuaj….

-Në datë 07.06.2018, ora 13:49, përdoruesi i numrit telefonik ****091 (Fredi Alizoti) telefonohet nga numri ****272 (Albert Veliu) dhe zhvillohet kjo bisedë:

Alizoti: Fol një herë me ata miqtë e vlla se unë s'dola dot andej poshtë. Mua më erdhën më degjeneruan dy herë në mëngjes, më mbajtën katër orë aty, më bënin presion. Mendo dhe për mua i q… motrën.

Veliu: Ore, po s'bëhet llaf, po rri rehat tani, boll tani.

Alizoti: Ai miku që ti njëherë më thoshe mua, fol, hap gojën sa do ore, unë sikur e kam…

-Në datë 12.06.2018, ora 12:55, përdoruesi i numrit telefonik *****091 telefonohet nga një numër ****974 dhe zhvillohet kjo bisedë:

Alizoti: Muhabet nuk ke dëgjuar në televizor ti, me shoku, po fola unë gjëra e ai muhabeti jam unë, e kape filmin ti? Unë bëra sikur isha vëllai i atij, e ke parasysh, dëgjon e?

974: Hë..

Alzoti: Bëra sikur isha vëllai i atij, e kupton ti, që do merrnim nga një bindshme e kupto ti?

974: eee. Alizoti: Po këta re burrë, po s'ishte e mirë ajo gjë, kupton ti, nga një qindëshe erdhi muhabet, prit re nga një qindëshe për një dyqindëshe e më tha mua nuk marrim dyqind, më tha mua do marrim njëqind, ore, mirë i thashë unë, mendova unë v.k. Mendova që po devijonte, ke parasysh ti çfarë tipi që ka ai. I thashë unë nëm një njëzetëshe, unë iki andej, lëviz, kupton ti.

### Britanikët: Kampioni "Agroni", i një cilësie shumë të dobët

# Foli Agron Xhafaj apo Alfred Alizoti? Ekspertiza: E paqartë, s'kuptohet mirë

Është vendosur kryerja e ekspertimit teknik, duke caktuar si ekspert, ekspertët britanikë të kompanisë "JP French Associates", i është kërkuar ekspertit t'u përgjigjet këtyre pyetjeve:

-Në materialin 1) objekt të ekspertimit-audio-video ka prerje, mbivendosje, montazhe apo ndërhyrje të çfarëdolloj tjetër me qëllim ndryshimin e përmbajtjes së materialit? Nëse po, ku konsistojnë ato?

-A ka vlera identifikuese materiali objekt ekspertimi për krahasim me persona konkretë?

-Personi i emërtuar - bashkëpunëtori X- në objektin e ekspertimit - a është shtetasi ALBERT VELIU?

-Personi i emërtuar - Agron-në objektin e ekspertimit, a është shtetasi GERON (AGRON) XHAFAJ?

-Personi i emërtuar- Agron-në objektin e ekspertimit, a është shtetasi AGRON HYSENI

-Personi i emërtuar- Agron-në objektin e ekspertimit, a është shtetasi FREDI ALIZOTI

Akti i ekspertimit ka konkluduar:

-Regjistrimet nuk janë regjistrime origjinale. Regjistrimi video ishte marrë nga pamjet e mediave. Ajo përbëhej nga dy video, shkrim dhe dy biseda të regjistruara. Këto dy biseda janë fokusi i analizës së ekspertes. Nuk ka qenë në gjendje të marrë regjistrimet origjinale të këtyre bisedave.



Albert Veliu

Biseda e parë: Biseda e parë ndodh në minutën 1 e 4 sekonda të kohës së videos dhe zgjat për 14 sekonda. Ajo duket të jetë një pjesë e një thirrjeje telefonike dhe folësit janë emërtuar "Bashkëpunëtori" dhe "Agroni", megjithatë vetëm e folura që i atribuohet "Bashkëpunëtorit" është e dëgjueshme (e kapshme) dhe për këtë arsye ekspertja ka ekzaminuar "Bashkëpunëtori", po jo "Agroni" nga kjo bisedë.

Biseda e dytë: Regjistrimi i dytë, i cili është një bisedë e bërë ballë për ballë, ndodh në minutën 1 e 25 sekonda të kohës së videos. Ajo zgjat 1 minutë dhe 46 sekonda. Përsëri, ajo është një bisedë midis burrit të quajtur "Bashkëpunëtori" dhe "Agroni". Në këtë regjistrim e folura nga të dy palët është e dëgjueshme (e kapshme). Ndërsa shumica e bisedës është midis "Agroni" dhe "Bashkëpunëtori" ka shenja (të dhëna) që në sfond është edhe zëri i një burri të tretë. Regjistrimi nuk e përmban bisedën e plotë. Nuk ka hapje të bisedës apo përshëndetje, gjëra të cilat për dikë janë të pritshme, si fillim kur palët takohen. Biseda vetë është shumë e shkurtër dhe, gjithashtu, shfaqen ndryshime shumë të papritura, sa i takon temave të bisedës.

Dy janë shpjegimet e mundshme: a) regjistrimi është një pjesë/pjesë të mbledhura nga një regjistrim më i gjatë, ose b) vetëm një pjesë e bisedës është regjistruar.

-Gjendet mbështetje e fortë në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar "Bashkëpunëtori" në bisedën e parë është Albert Veliu;

-Gjendet mbështetje e fortë e moderuar në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar "Bashkëpunëtori" në bisedën e dytë në fjalë është Albert Veliu;

-Gjendet mbështetje e fortë në qëndrimin se folësi në fjalë i emërtuar "Agroni"; në bisedën e dytë në fjalë nuk është Agron Hyseni. Vërehen ndryshime të rëndësishme forensike midis zërit të "Agroni" dhe atij të z.Hyseni.

-Kampioni i bisedës në regjistrimin "Agroni" në bisedën e dytë, objekt ekspertimi, nuk është i përshtatshëm për të arritur në konkluzion (pozitiv ose negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj. Kampioni i ligjëratës (të folurit) në "Agroni" nuk është i mjaftueshëm (adekuat) për të arritur në konkluzion (pozitiv apo negativ) lidhur me zotërinjtë Alizoti dhe Xhafaj. Kampioni "Agroni" është i një cilësie shumë të dobët.

# AUDIOPËRGJIMI
## REAGIMET

Konspiracion për rrëzimin e qeverisë? Kreu i PD i përgjigjet Ramës: Metodë enveriste

# "Babalja 1", Basha: Po manipulohen hetimet, përballja me drejtësinë

## "Krimi në Bllok, Tahiri ishte në Gjermani me Matën"


Gjatë një seance parlamentare

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, në përgjigje të kryeministrit Rama deklaroi me bindje të plotë se në audiopërgjimin ku akuzohet vëllai i ministrit të Brendshëm është zëri i Agron Xhafajt. Sipas tij, videoja me të cilën PD akuzon Agron Xhafajn si i përfshirë në trafik droge është e pamanipuluar. Por, Lulzim Basha garantoi se: "Aktori i vetakuzuar dhe vetofruar është një lojë banale dhe e trashë e krerëve të policisë dhe prokurorëve nën udhëzimin e Fatmir Xhafajt. Kjo është një vepër e rëndë penale, do të përballen me drejtësinë. Unë po pres të shoh sa shumë do të zhyten në këtë histori Rama, policia dhe prokuroria. Presim të shikojmë ekspertizën italiane, apo refuzimin e Italisë. Pres konkluzionet për hetimin e pasurisë së Agron Xhafajt. Po pres që prokuroria të marrë në pyetje Ramën dhe Xhafajn". Në një bashkëbisedim me gazetarët, Basha akuzoi dje Prokurorinë e Krimeve të Rënda se po manipulon hetimet. "Videoja është e pamanipuluar. Zëri është i Agron Xhafajt. Agron Xhafaj ka qenë i përfshirë në trafikun e drogës, ka qenë një nga kokat kryesore të trafikut të drogës. Sado që të manipulojnë hetimet, nuk do ia dalin dot. Prokuroria ka çuar një kopje të videos, të marrë nga media dhe jo videon origjinale. Ky është një veprim i qëllimshëm i prokurorisë, që ekspertiza ta kishte të vështirë të identifikonte. Kampionët e Agron Xhafajt janë marrë jashtë çdo rregulloreje dhe kanë qenë shumë të dobëta qëllimisht që të mos dallohej. Ekspertiza angleze nuk përjashton që ai është zëri i Agron Xhafaj. Agron Xhafaj nuk është marrë në pyetje. Prokuroria ka bërë hetim pa marrë në pyetje Agron Xhafajn", theksoi kreu i PD-së.

**AKUZA**

Prokuroria e Krimeve të Rënda u vu nën akuzë nga Basha se është kthyer në celulë të krimit dhe bandave, duke shkatërruar çdo provë që sipas tij implikon zyrtarë të lartë të PS të lidhur me eksponentë të krimit e bandave. Audiopërgjimi në të cilin opozita pretendon se është i përfshirë në pazare droge vëllai i ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj, sipas Bashës është edhe prova e fundit e vënies së organit të akuzës në shërbim të krimit. Ndaj, edhe deklaratën e kryeministrit se "Babalja" është konspiracion për të rrëzuar qeverinë e sheh si teatër me regjisor Edi Ramën. "Tani në këtë moment ku është, e vetmja që kontrollon Edi Rama është godina e Kryeministrisë, ka humbur çdo kontroll mbi territorin, mbi qeverisjen, ka përqafuar metodën enveriste të konspiracioneve. E dëgjuat si tha sot? Ne. Kush ne? Ti je ekzekutivi. Shteti dhe partia do të zbulojnë konspiracionin, kjo ishte metoda enveriste, sa herë kishte një skandal, zbulonte konspiracionin. Dhe tani shikojeni ku ka degjeneruar ky, ku ka arritur mendja e tij. Nuk arrin të pjellë imagjinata e tij as diçka fine, ka kaluar në të njëjtin fjalor si në kohën e Enver Hoxhës. Ka zbuluar konspiracione nga opozita për të rrëzuar pushtetin popullor. Vetëm një mendje e sëmurë mund të ketë një imagjinatë të tillë, banale, që të paraqesë situatën kriminale dhe lidhjet kriminale të pushtetarëve si konspiracion në kohën e Enver Hoxhës", - tha z.Basha.

**KRIMI**

Për kreun e opozitës, rendi kushtetues ka rënë, krimi kontrollon gjithçka dhe vendi ndodhet përpara një emergjence kombëtare. Për këtë solli si dëshmi përplasjen me armë të së enjtes në zonën e ish-Bllokut. Sipas tij, përplasja e ndodhur të enjten e 4 tetorit ka ndodhur për pazare droge. Gjatë bashkëbisedimit me gazetarët, Basha zbuloi edhe një detaj tjetër. Biznesmeni Ervin Mata, i cili është shpallur në kërkim si i përfshirë në përplasjen me armë në lokalin tek ish-Blloku ka shoqëruar ish- ministrin Saimir Tahiri gjatë vizitës së këtij të fundit në Gjermani. "Ngjarja e fundit në Tiranë që na u shit për 4 ditë si përplasje për një këngëtare është zbuluar se është përplasje për pazare droge, ku janë përfshirë trafikantë të njohur dhe të dokumentuar për lidhje me pushtetin. E mbani mend kur Saimir Tahiri u nis për në Gjermani pasi i ktheu pasaportën? E dini me kë ishte në Gjermani? Me këtë Matën e përfshirë në lokal në goditjen me armë mes bandave rivale. Ku ka ndodhur kjo? Në zemër të Tiranës, në një lokal të preferuar nga ministri Arben Ahmetaj dhe politikanë të tjerë", tha Basha. "E vetmja mënyrë për të ndalur të keqen - shprehet z.Basha - është populli, pasi bandat kanë marrë nën kontroll shtetin dhe se kryeministri është vënë në shërbim të grupeve kriminale më të rrezikshme në vend".


Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje gjatë bisedës me gazetarët

**EKSPERTIZA**

"Ekspertiza private angleze, analiza e dytë, sepse e çuan njëherë në laborator në Romë dhe nuk e mor vesh se çfarë u tha laboratori Romës, pra ekspertiza angleze nuk përjashton mundësinë që mund të jetë zëri i Agron Xhafajt. Përkundrazi, zëri në video dhe zëri i marrë në laborator, të çuara kastile me cilësi të dobët janë të afërt dhe mund të jetë zëri i Xhafajt", - tha z.Basha.

**PËRBALLJA**

"Aktori i vetakuzuar dhe vetofruar është një lojë banale dhe e trashë e krerëve të policisë dhe prokurorëve nën udhëzimin e Fatmir Xhafajt. Kjo është një vepër e rëndë penale, do të përballen me drejtësinë. Unë po pres të shoh sa shumë do të zhyten në këtë histori Rama, policia dhe prokuroria. Presim të shikojmë ekspertizën italiane, apo refuzimin e Italisë. Pres konkluzionet për hetimin e pasurisë së Agron Xhafajt. Po pres që prokuroria të marrë në pyetje Ramën dhe Xhafajn", tha Basha.

"S'më trembin manipulimet. Asnjë kontakt me Alizotin"

# Audiopërgjimi, Salianji: Prokuroria ka çuar materialin nga mediat për ekspertim



Deputeti demokrat, Ervin Salianji, një nga emrat që denoncoi së pari audiopërgjimin ku përfshihej Agron Xhafaj, foli dje në "News 24" për çështjen që po zien ende në prokurori, gjykatë e politikë. Salianji është përmendur nga Fredi Alizoti, personi që thuhet nga prokuroria s'e ka interpretuar Agron Xhafajn dhe shprehet se deputeti i PD i kishte premtuar 200 mijë euro për ta kryer këtë gjë. Salianji deklaroi se nuk e njeh dhe nuk ka komunikuar asnjëherë me Fredi Alizotin dhe se gjithçka është inskenim. "Kjo është çështja 'Xhafaj' jo 'Babalja'. Për të qenë të sinqertë para publikut në fashikullin e prokurorisë, nuk ka prokuroria në asnjë rast të përmendur emrin tim. Një shok i Edi Ramës përmend emrin tim sikur i kisha premtuar 200 mijë euro. Nëse do ishte një fakt i tillë, unë s'do isha në këtë studio, s'do kishim kallëzim të rremë, por korrupsion. Kryeministri në shkelje të Kushtetutës tha unë kam ngritur një grup pune për këtë çështje. Prokurorëve ua kam thënë vetë që unë me këtë personin nuk kam asnjë kontakt, zero. Është një inskenim i turpshëm për të shpëtuar atë që nuk e shpëtuan dot me ekspertizën. Këta kanë shpikur jo një, por dy aktorë. Nuk është vetëm Fredi Alizoti, por edhe Agron Hyseni. Prokuroria ka çuar një grup me aktorë. Aktekspertimi britanik thotë që regjistrimi video është marrë nga pamjet e mediave. Ne nuk i kemi dhënë pamjet e mediave prokurorisë", tha Salianji.

# "Babalja", Berisha: Ekspertiza angleze nxori zbuluar Ramën

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi pas ekspertizës së zërit të verifikuar në Mbretërinë Bashkuar, e cila sipas tij provon se zëri në audio është i Agron Xhafajt, vëllai i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafajt. Berisha liston disa argumente, që në optikën e tij, tregojnë qartë dhe nxjerrin zbuluar mazhorancën dhe kryeministrin Rama. Berisha shkruan se shqiptarët ende nuk kanë parë gjë akoma. "Ekspertiza britanike zhvesh cullak Kallam Dështakun. Provon si supertrafikant Geron Xhafajn! Ajo fakton: Zëri i materialit të regjistrimit është i ngjashëm me zërin e supermafiozit qeveritar Agron/Geron Xhafaj. Zëri i materialit të bisedës midis Geron Xhafajt dhe Albert Veliun nuk ngjason me zërin e aktorit Fredi Alizoti, por me atë të Agron Xhafajt! Kallam Dështaku ka dërguar në Britaninë e Madhe jo materialin origjinal të bisedës së regjistruar midis Geron Xhafajt dhe Albert Veliut, por ka dërguar vetëm kopjen e regjistrimit të paraqitur nga mediat me titrime, me qëllim që të pengojë ekspertizën, e cila kërkon gjithnjë materialin origjinal dhe jo kopjen për të nxjerrë përfundimin e saktë. Ekspertiza britanike i jep goditje asgjësuese ekspertizës brenda 24 orëve të Kallam Dështakut, i cili pasi organizoi bisedën telefonike midis Fred Alizotit dhe Alfred Veliut (në qendrën e azilit në Kosove) deklaroi publikisht se zëri nuk është i Geron Xhafajt, duke besuar se do mund të shiste zërin e aktor Alizotit për zërin e Xhafajt", tha Berisha.



Kryeministri fton opozitën: Ndryshime në Kodin Penal, dënime ekzemplare për "të fortët"

# Audiopërgjimi, Edi Rama: "Babalja", konspiracion për rrëzimin e qeverisë

## "Monitorim të rreptë të dënuarve në burgjet e sigurisë së lartë"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama e cilësoi një "konspiracion për rrëzimin e qeverisë", të gjithë historinë e audipërgjimit për vëllain e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Në një konferencë për median, Rama u shpreh se, "në filmin 'Babale 1' kemi bashkëpunim me elementë të krimit të organizuar, të burgosur për krim të organizuar, kemi korrupsion, kemi përfshirje të drejtpërdrejtë të partisë politike në bashkëpunim dhe me oferta korruptive dhe kemi edhe më shumë se kaq, sepse filmi është konceptuar dhe skenari është shkruar në dy skuta të shtetit shqiptar. Unë do ju ftoja që të jepnit një ndihmesë për publikun që kjo shfaqje ekstreme e brutalitetit të politikës më të ulët ndaj opinionit publik të mos kalojë si një nga shfaqjet e radhës". Kryeministri nuk dha më shumë detaje, duke i kërkuar medias të bënte punën e saj dhe të zbulonte. "I di të gjitha, nga fillimi deri në fund, sepse kam angazhuar një grup të posaçëm që është marrë nga fillimi deri në fund për të ditur unë vetë, në radhë të parë, të gjithë të vërtetën dhe pres që e vërteta të dalë e plotë, nuk kam për ta lënë pa e nxjerrë edhe sikur për 1001 arsye të mosarsyes të mbulohet, apo të zbutet. Natyrisht që unë nuk jap vendime, as bëj pretenca. Për fat të mirë jemi në një sistem ku detyrat janë të ndara, pushtetet janë të ndara, por të jeni të bindur që shqiptarët do ta mësojnë nga A-ja tek ZH-ja, jo me institucionet, por me emra e me mbiemra, kush është përfshirë në këtë konspiracion të mirëfilltë për rrëzimin e qeverisë, se i tillë është", deklaroi Rama. I pyetur për rolin e ish-kreut të kundërzbulimit të FBI, Lou Bladel në grupin që kryeministri tha se ishte ngritur, Rama nuk dha shumë detaje. "Ne jemi shumë seriozë në të gjithë përpjekjen tonë në luftën kundër krimit, në luftën kundër burimeve që financojnë krimin, në luftën kundër shmangies nga detyrimet, të pastrimit të parave dhe të evazionit", tha kryeministri, i cili lidhur edhe me ngjarjen e Xhisiela Malokut u sugjeroi gazetarëve të gjejnë pamje nga komisariati i Fushë-Krujës, ku jo Taulant Balla, por as vetë oficeri që pretendon se i kanë vënë revolen në kokë nuk figuron të ketë qenë në kamera atë ditë.

### MASAT

Kreu i qeverisë njoftoi se mazhoranca do të ndërmarrë ndryshime ligjore për të dyshuarit apo për të dënuarit për përfshirje në krim të organizuar, apo dhe organizata terroriste, të cilët do t'i nënshtrohen një regjimi të ri shumë të rreptë, izolimi dhe monitorimi, duke iu ndërprerë çdo lloj komunikimi të brendshëm dhe të jashtëm për të gjithë kohën e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit. Ata sipas këtij propozimi, do të kenë kontakte shumë të kufizuara me qeniet e tjera njerëzore dhe shumë rreptësisht të monitoruara për të gjithë kohën e vuajtjes së dënimit të tyre. Po ashtu, do të ngrihet një sallë operative monitorimi non-stop me kamera të burgjeve të sigurisë së lartë, duke filluar nga burgu "313" dhe nga godina e operacionit "Forca e Ligjit". Ndërkohë, në Shërbimin e Kontrollit të Burgjeve do të ngrihet një sallë operative monitorimi non-stop e të gjitha institucioneve peniteciare të Republikës së Shqipërisë. Kjo e çon sigurinë e burgjeve në një nivel të panjohur më parë, u shpreh Rama. "Qeveria ka nisur draftimin e një pakete ndryshimesh në Kodin Penal për të fortët. Kështu quhet paketa, 'Të fortët', të cilëve përmes një trajtimi ekzemplar, përmes përshkallëzimit të presionit të Policisë së Shtetit në çdo territor, do t'u rezervojmë edhe ndëshkime penale ekzemplare për format e tyre të preferuara të karshillëkut ndaj ligjit, ndaj qytetarëve dhe ndaj biznesit. Së shpejti, natyrisht, duke qenë se bëhet fjalë për ndryshime në Kodin Penal, këtë paketë do ta ndajmë me opozitën, duke shpresuar në mundësinë e kthimit të saj nga bota e filmave, në terrenin e përballjes reale me kriminalitetin", theksoi Rama.



**OFICERËT E SIGURISË**

Qeveria ka vendosur zbatimin e programit të ri për oficerët e sigurisë në shkollat e vendit. Ky program që nisi fazën pilot në 15 shkolla do të shtrihet në 150 shkolla, gjimnaze kryesisht, ku do të fillojnë nga puna menjëherë 150 oficerë sigurie, të trajnuar enkas për këtë program.

**TAULANT BALLA**

Seanca e parë gjyqësore mes Taulant Ballës dhe Lulzim Bashës do zhvillohet sot në Gjykatën e Tiranës. "Lulzim, ndjesë nëse je duke veshur pizhamat, po kisha merak se të zinte gjumi, prandaj të shqetësoj për kujtesë. Nesër (sot) në 9.30 kemi gjyqin për shpifjen tënde, mos harro! Të pres të nxjerrësh qoftë edhe një provë të vetme për akuzat e tua. Nëse s'të del gjumi, mos merr raport mjekësor!", iu drejtua Balla, Bashës dje.

### Ministri i Brendshëm paraqet shifrat e krimit

## Xhafaj, Bashës: Je ish-ministri më i paaftë, punuam palodhur kundër krimit

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ka reaguar përmes paraqitjes së shifrave, pas deklaratave të kryetarit të PD-së, Lulzim Basha, për kriminalitetin në vend. Përmes një reagimi në "Twitter", Xhafaj tha se puna e qeverisë është pa kompromis me botën e krimit dhe rezultatet janë të vërteta. "Basha, tha: 'Ju parashtroj… një çështje kapitale, emergjence kombëtare, siç është gjendja e rendit e shpartallimit të plotë të institucioneve të zbatimit të ligjit!'. Një e pavërtetë e madhe, dalë nga goja e ish-ministrit të Brendshëm më të paaftë në vite. Të dhënat e faktet mbi punën tonë të palodhur e pa kompromis me botën e krimit dhe rezultatet konkrete janë e vërteta. Krahaso çdo shifër e të dhënë të kohës së L.B. si ministër i Bre-ndshëm, me ato të këtyre 2 viteve të fundit. Shihni dhe gjykoni. Imazhe sa për 1000 fjalë!", - tha Xhafaj, ndërsa ka publikuar me grafikë shifrat krahasuese me kohën kur ministrinë e ka drejtuar Basha, me periudhën e drejtimit të socialistëve.



### Kreu i grupit të LSI sulmon kryeprokuroren

## "Babalja", Vasili: Populli do t'i trajtojë Ramën e Markun si puçistë

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, sulmoi dje kryeministrin Edi Rama dhe prokuroren e Përgjithshme, Arta Marku, lidhur me çështjen "Babalja". Përmes një statusi në "Facebook", Vasili theksoi se populli do t'i trajtojë Ramën dhe prokurorinë si puçistë. Sipas Vasilit, prokuroria është shndërruar në instrument i puçit. Po ashtu, Vasili pohon se kryeprokurorja Arta Marku nuk shpëton dot nga përgjegjësia e rëndë e bllokimit të marrjes si i pandehur të Edi Ramës. "Prokuroria, zorra qorre e kryeministrit, puç kundër popullit, që do t'i trajtojë të dy si puçistë. Shqipëria po përballet haptazi me një puç të qeverisë dhe kryeministrit të krimit kundër drejtësisë, kundër sigurisë vetjake dhe të drejtave e lirive minimale të qytetarëve, hapur në mbrojtje të kriminelëve dhe banditëve. Prokuroria, e shndërruar në zorrën qorre të kryeministrit, është tashmë haptazi bashkëpjesëmarrëse dhe instrument i puçit", u shpreh Vasili. "Kryeministri bandit, tashmë edhe kryeprokuror, ka sekretare Arta Markun, që vetëm zbardh vendimet e tij, duke marrë përgjegjësi penale dhe publike shumë të rënda mbi vete. Arta Marku nuk shpëton dot as sot, as kurrë nga përgjegjësia shumë e rëndë e bllokimit të marrjes i pandehur të Edi Ramës, që gjoja bëri ekspertizën e audiopërgjimit të Agron Xhafajt katër muaj para saj. Përpara këtij puçi, populli nga sot ka të gjithë të drejtën ta godasë kryeministrin dhe kryeprokuroren si ta gjykojë ai dhe gjyqi i tij është pa shpëtim, legjitim dhe i pashmangshëm", u shpreh Vasili.




**Petrit Vasili**

"Kryeministri bandit, tashmë edhe kryeprokuror, ka sekretare Arta Markun, që vetëm zbardh vendimet e tij, duke marrë përgjegjësi penale dhe publike shumë të rënda mbi vete. Arta Marku nuk shpëton dot as sot, as kurrë nga përgjegjësia shumë e rëndë e bllokimit të marrjes i pandehur të Edi Ramës, që gjoja bëri ekspertizën e audiopërgjimit të Agron Xhafajt katër muaj para saj".

INTEGRIMI

KUSHTET

Kukan: Qeveria shqiptare të zgjidhë problematikën në rritje të krimit dhe korrupsionit

# PE, pa datë për negociatat e Shqipërisë: Përmbushni kushtet

## *Fleckenstein: Zbatoni reformën në drejtësi*



Valentina Madani

Parlamenti Europian miratoi dje rezolutën për përparimin e Ballkanit Perëndimor me 44 vota pro, 5 kundër dhe 5 abstenim. Raporti i eurodeputetit Knut Fleckenstein mbi progresin e Shqipërisë në rrugën e integrimit europian për vitin 2018 është mbështetur gjerësisht nga Komisioni i Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian. Në raport thuhet se Parlamenti Eevropian ka mirëpritur progresin e Shqipërisë, por eurodeputetët kanë ngritur si shqetësim nivelin e korrupsionit dhe mungesën e efikasitetit në drejtësi. Në diskutime janë përmendur disa çështje të nxehta si negociatat me Greqinë, veçanërisht respektimin e të drejtave të pakicave, por edhe ndërtimet e hidrocentraleve në disa lumenj në vendin tonë. Parlamenti Europian është shprehur i prerë në qëndrimin e tij se negociatat për anëtarësimin do të hapen kur Shqipëria të përmbushë kushtet e nevojshme e jo në ndonjë datë të caktuar. Raporti i PE-së konfirmon deklaratën e pak ditëve më parë të ministrit të Jashtëm të Gjermanisë, i cili u shpreh se nuk ka një datë të saktë për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE. Raporti i eurodeputetit Knut Fleckenstein njeh progresin e bërë me fillimin e zbatimit të reformës së drejtësisë dhe procesit të vetingut për të rritur pavarësinë dhe profesionalizmin e gjyqësorit. Por, dobësia kryesore e vendit për eurodeputetët mbetet zbatimi i pesë prioriteteve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Në kompromiset dhe amendamentet e votuara nga eurodeputetët shprehet shqetësimi për nivelin e lartë të korrupsionit, ritmi i ngadaltë dhe joefikasiteti i sistemit të drejtësisë, si dhe fakti që mangësitë e sundimit të ligjit dhe procedurat e vështira rregullatore vazhdojnë të pengojnë investimet në vend. Eurodeputetët kërkojnë në mënyrë këmbëngulëse rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikut të narkotikëve, pastrimit të parave, zgjidhjen e çështjes së pronave dhe respektimin e standardeve europiane për ndërtimin e hidrocentralit mbi lumin Vjosa dhe hidrocentraleve të tjera. Raporti për Shqipërinë pritet të votohet në seancë plenare të Parlamentit Europian në fillimit të nëntorit. Gjatë debatit, Fleckenstein vuri në pah ecurinë e mirë të procesit të vetingut, por ka kërkuar vijimin e zbatimit të reformës në drejtësi dhe rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Ne mirëpresim qëndrimin e Këshillit të Ministrave për të hapur negociatat vitin e ardhshëm. Jemi të kënaqur me përparimin e reformës ambicioze të drejtësisë dhe po shohim frytet e para të saj dhe ecurinë pozitive të procesit të vetingut", tha z. Knut Fleckenstein. Kurse eurodeputeti Kukan deklaroi: "Ne duhet të përçojmë mesazhet kryesore përmes këtij raporti. Së pari, Shqipëria ka bërë progres dhe ne duhet të mbështesim hapjen e negociatave në qershor të vitit 2019. Duhet të jemi realistë, qeveria shqiptare duhet të zgjidhë problematikën në rritje të krimit të organizuar dhe korrupsionit në vend, që në shumë mënyra po cenojnë progresin e vendit".



Parlamenti Europian

**KUKAN**

Eurodeputeti Kukan deklaroi: "Ne duhet të përçojmë mesazhet kryesore përmes këtij raporti. Së pari, Shqipëria ka bërë progres dhe ne duhet të mbështesim hapjen e negociatave në qershor të vitit 2019. Duhet të jemi realistë, qeveria shqiptare duhet të zgjidhë problematikën në rritje të krimit të organizuar dhe korrupsionit në vend, që në shumë mënyra po cenojnë progresin e vendit".

**TAKIMI**

Bashkëpunimi dypalësh dhe interesi i përbashkët për të intensifikuar bashkëpunimin ekonomik e tregtar u diskutua dje mes Presidentit Ilir Meta dhe Sekretarit të Shtetit të MPJ së Hungarisë, Péter Sztáray. Me interes u bashkëbisedua edhe për zhvillimet më të fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe të ardhmes euroatlantike të vendeve të rajonit.

### Kreu i OSBE: Reforma të mbyllet 6 muaj para zgjedhjeve

## "Zgjedhorja", Soreca: Partitë të bashkëpunojnë, të mbyllet në kohë




Pas prezantimit të plat formës së opozitës për çlirimin e zgjedhjeve, dje u organizua tryeza e debatit për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Kreu i deputetëve socialist, Taulant Balla, ftoi opozitën për të bashkëpunuar në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe shprehu gatishmërinë e mazhorancës për përdorimin e teknologjisë në zgjedhjet e 2019-ës. E pranishme në diskutim, ambasadorja gjermane Susanne Schutz rikujtoi se reforma zgjedhore është një nga kushtet për negociatat dhe i bëri thirrje opozitës të vijë dhe të përmbyllë reformën. "Ne presim që të gjithë grupet parlamentare, duke përfshirë edhe opozitën, të heqin dorë nga qëndrimi bllokues dhe të kthehen në parlament për të vijuar menjëherë me reformën zgjedhore dhe për ta bërë atë të zbatueshme deri në zgjedhjet e ardhshme vendore", tha Susanne Schutz. Kurse ambasadori i BE-së në Tiranë, Luigi Soreca thekson se reforma zgjedhore është kyçe për Shqipërinë në rrugën drejt anëtarësimit në BE. "Ne presim që partitë politike të punojnë së bashku për reformën zgjedhore, duke u angazhuar në mënyrë gjithëpërfshirëse për të trajtuar rekomandimet prioritare të OSBE-ODIHR-it. Në Komisionin Parlamentar Ad-Hoc është bërë një punë shumë e mirë për reformën zgjedhore. Këto përpjekje duhet të përfundojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, me ndryshime në ligjin zgjedhor, të miratuara në kohën e duhur para zgjedhjeve vendore të vitit 2019", tha z. Soreca. Ndërsa, kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Borchardt vlerëson vënien në tryezë të një drafti për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, duke theksuar se praktikat më të mira ndërkombëtare për reforma të tilla kërkojnë që ajo të miratohet 6 muaj përpara zgjedhjeve. "Praktikat më të mira ndërkombëtare për reformë zgjedhore kërkojnë që këto reforma të miratohen të paktën gjashtë muaj përpara zgjedhjeve. I nxisim të gjithë aktorët politikë të përfshihen në dialog konstruktiv në lidhje me këtë draft", - tha z. Borchardt.

**REFORMA**

"Praktikat më të mira ndërkombëtare për reformë zgjedhore kërkojnë që këto reforma të miratohen të paktën gjashtë muaj përpara zgjedhjeve".



**DITMIR BUSHATI**
"Lajm i mirë nga Komisioni i Parlamentit Europian për punët e Jashtme. Resoluta konfirmon progres të qëndrueshëm në reformat e lidhura me BE dhe konfirmon rrugën e vendosur nga Këshilli për hapjen e negociatave në Qershorin e 2019", tha dje, ministri i Jashtëm pas miratimit të rezolutës për Shqipërinë nga PE.




**"Prodhimi kombëtar pritet të zgjerohet me 4% gjatë këtij viti"**

## Parashikim më i lartë për rritjen ekonomike, FMN: Shqipëria, më mirë

Pas Bankës Botërore, edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) përmirësoi parashikimin për rritjen ekonomike të Shqipërisë. Në raportin e fundit "Perspektiva e Ekonomisë Botërore" FMN vlerëson se prodhimi kombëtar i Shqipërisë pritet të zgjerohet me 4% gjatë këtij viti, nga 3.7% që ishte vlerësimi i mëparshëm. Përmirësimi i vlerësimeve për rritjen e prodhimit kombëtar të Shqipërisë vjen pas ecurisë pozitive të ekonomisë në gjysmën e parë të vitit. Për gjashtë muajt e parë, ekonomia shqiptare u rrit me 4.4% në terma vjetorë, një normë kjo dukshëm mbi pritshmëritë e udhëhequra nga performanca e fortë e sektorit energjetik. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, rritja e prodhimit të energjisë ka dhënë gati gjysmën e rritjes ekonomike, ndërkohë që ecuri pozitive ka patur dhe prodhimi industrial, i cili u zgjerua me 12.5%. Ky është viti i pestë me radhë që ekonomia shqiptare përshpejton ritmet e rritjes, por sipas FMN-së kjo seri pozitive pritet të përfundojë vitin e ardhshëm. Fondi parashikon se në vitin 2019 rritja e ekonomisë shqiptare pritet të ngadalësohet në 3.7%, e kushtëzuar kryesisht nga përfundimi i dy investimeve të mëdha energjetike, gazsjellësi transadriatik dhe kaskada e Devollit. Sipas FMN-së, pas ngadalësimit të pritshëm gjatë vitit të ardhshëm, rritja ekonomike do të rikthehet sërish në nivelin 4%, një normë e cila ndonëse është më e lartë sesa mesatarja e vendeve të rajonit, mbetet më e ulët nga ritmet e para krizës, kur ekonomia shqiptare rritej me 6% në vit.

### Vendimi/ Ikin nga zonat e banuara rreth 1500 kazino elektronike

# Qeveria, nga 31 dhjetori mbyllen rreth 4 mijë pika bastesh në zonat e banuara

## "Brenda 24 orësh të heqin të gjitha reklamat nga ekranet"

Qeveria do të mbyllë rreth 4 mijë pika bastesh në qendrat e banuara duke filluar që nga 1 janari i vitit që vjen. Kryeministri njoftoi dje, sipas ndryshimit të bërë në ligjin për lojërat e fatit, "duke nisur nga data 31 dhjetor të këtij viti do të pushojnë së funksionari të gjitha kazinotë elektronike. Ndryshimi përfshin edhe bastet sportive, si dhe çdo lloj basti për çdo garë të ashtuquajtur në pistë, me kuaj, me qen, apo me çdo lloj skllavi të faunës shqiptare. Ndërkohë po punohet për regjimin e ri të licencimit dhe të kontrollit të kësaj veprimtarie në distancë, pra, nëpërmjet internetit dhe brenda po këtij afati, 31 dhjetorit, ne do të kemi një regjim të ri gati". "Për ata që po synojnë ta çajnë rrethimin për ligjin ekzistues, me metodat që e canë koalicionin qeverisës kur u shty mbyllja e këtij aktiviteti marrëzie kombëtare, sqaroj dhe një gjë tjetër, që Lotaria Kombëtare nuk do ketë asnjë element të kazinove elektronike, ose siç njihen në gjuhën zyrtare "VLT"", tha më tej Rama. "Duke qenë se Lotaria Kombëtare është në koncesion i bërë, siç e dini në të shkuarën, bazohet në një ligj të veçantë dhe tej argumenteve të biznesit, të punësuarve, të të ardhurave, të cilat për hir të së vërtetës janë thuajse dyfishuar në raport me të shkuarën, - 54 milionë dollarë nga rritja e formalitetit dhe nga taksat përmes formalizmit, pavarësisht se 40 komani kishte në të shkuarën dhe mblidheshin gjysma e taksave, tani ka 20 dhe mblidhen dyfishi i taksave, - në territorin e Republikës së Shqipërisë nga 1 janari nuk do ngrihet më asnjë qepen për baste dhe ashtu siç është përcaktuar në ligjin ekzistues nuk do ngrihet më asnjë qepen për kazino elektronike në asnjë zonë të banuar në 28 mijë km katror të Republikës së Shqipërisë", sqaroi kryeministri. Sipas tij, në zbatim të ligjit ekzistues, që ndalon reklamimin e kompanive të basteve dhe që është shkelur nga të gjitha mediat pa përjashtim, unë i paralajmëroj të gjithë: Brenda 24 orësh të heqin të gjitha reklamat nga ekranet, nga radiot, nga gazetat, apo nga portalet. AMA duhet të garantojë zbatimin e ligjit për sa i përket ekraneve dhe radiove, ndërsa ne do të mbyllim me forcë çdo faqe online, që pas 24 orësh do të ketë akoma reklama bastesh në shkelje të ligjit ekzistues të Republikës së Shqipërisë". Po sot, qeveria ka pezulluar veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, i cili deri në 31 dhjetor do të transformohet dhe do të robotizohet përmes teknologjisë digjitale, për të funksionuar si mbikëqyrës në regjimin e ri. Biznesi i lojërave të fatit është rritur vit pas viti dhe duket se edhe në 2017 regjistroi një tjetër ecuri pozitive. Sipas të dhënave të përpunuara nga 'Monitor', bazuar në xhirot e deklaruara të 14 kompanive kryesore të kazinove, basteve, loto, bingo, lotari, qarkullimi vjetor zyrtar i industrisë ishte 16.6 miliardë lekë, ose rreth 132 milionë euro.



Foto ilustruese

**SHIFRAT**

Sipas të dhënave zyrtare nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në maj të këtij viti, në Shqipëri numëroheshin 3.916 pika bastesh, ose 1 loto për çdo 730 banorë.

### SHITJA E TELEKOM

Kryeministri Edi Rama u pyet dje, për shitjen e Telekom Albania, për të cilën ka një ofertë nga Telekom Serbia. Një ditë më parë Presidenti serb Vuçiç tha se do ta zgjidhte me kryeministrin Rama këtë çështje. "Qeveria shqiptare nuk është pjesë e transaksionit që do të kryejë një kompani private si Deutsche Telekom, e cila ka një strategji tërheqje nga tregjet e vogla dhe po bën shitje, jo vetëm në Shqipëri, me kompaninë që do të zgjedhë të shesë biznesin. Por ky është një sektor strategjik dhe natyrisht, qeveria shqiptare pyetet, i kërkohet një mendim nga vetë ata që janë të interesuar. Qëndrimi i qeverisë shqiptare është shumë i thjeshtë dhe shumë i qartë, bizneset serbe janë të mirëpritura në Republikën e Shqipërisë, por në këtë sektor strategjik nuk është preferenca jonë",-u shpreh Rama.

## Kreu i PD-së: Olsi Rama lidhje me koncesionin e lojërave të fatit

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha deklaroi dje, pas vendimit të qeverisë për heqjen e kazinove nga zonat e banuara nga 1 janari se "industria e pastrimit të parave është tërësisht e kontrolluar nga kriminelët në bashkëpunim me politikanët më të lartë në vend. Dihet qartë se koncesioni i lojërave të fatit operohet nga fasada e të vëllait të kryeministrit, Olsi Ramës". "Dihet qartë se segmentet më të mëdha të lojëra të fatit janë në duart e krimit të organizuar. Kështu që mos nxirrni asnjë konkluzion nga një njeri që ka humbur çdo kontroll mbi qeverisjen, territorin dhe mendjen e vetë që shikon konspiracion apo mundohet t'u thotë shqiptarëve se ka konspiracion opozitar sa herë që kapet në krim. Nëse kjo do të bëhet për të transferuar interesat kriminale të pastrimit të parave për t'i përqendruar apo për t'i kamufluar në mënyra të tjera pritet që ta shohim", u shpreh Basha. E mbani mend "Marrëzinë e fundit" apo jo. Marrëzia e fundit nisi për të mbyllur pikat e lojërave të fatit. Ishin 834 dhe sot janë 4200. Me këtë rregull i bie që pas shpalljes së Edi Ramës të shkojmë 8400. Pra nëse na mëson një gjë historia me këtë njeri është që tjetër gjë thotë e tjetër gjë bën",-tha më tej, Basha.



### Krimet e Rënda firmosin moskompetencën

## Sulmi me armë ndaj policisë, hetimet nga prokuroria e Elbasanit




**TIRANË** - Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kaluar për kompetencë në Prokurorinë e Elbasanit hetimet për sulmin ndaj policisë, ngjarje kjo e ndodhur në shtator të vitit të kaluar në këtë qytet. Mësohet se prokurori Gentian Osmani me anë të një shkrese zyrtare të drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka njoftuar se nuk ka kompetencë për të hetuar Marjus Lulajn, Enea Bekteshin dhe Klemend Xhaferrin. Në kërkesën e tij në cilësinë e zëvendës/drejtuesit të Krimeve të Rënda, thuhet se ai ka moskompetencë lëndore për këto hetime. Sipas informacioneve, Suel Çela, Enea Bekteshi dhe Klemend Xhaferri po hetoheshin me masë sigurimi "arrest me burg", pasi akuzoheshin se në shtator të vitit 2017, kanë tentuar të vrasin punonjës policie, në një ngjarje të ndodhur në hyrje të Tregut Ushqimor të Elbasanit. Pas më shumë se një viti hetimesh, Prokuroria e Krimeve të Rënda, ka vendosur të mos e hetojë më këtë çështje. Në një shkresë zyrtare, Donika Prela ka autorizuar zëvendësin e saj, Gentian Osmani, që të njoftojë gjykatën mbi vendimin e prokurorit të çështjes për kalimin e dosjes për kompetencë në Prokurorinë e Elbasanit.

### "Blindohet" gjykata, policët me antiplumb

## Avokatët të papërgatitur, shtyhet seanca për Shullazin e grupin e tij



**TIRANË** - Një javë më parë, Prokuroria e Krimeve të Rënda dha pretencën për Emiljano Shullazin dhe 4 anëtarë të tjerë të grupit të tij, që akuzohen për gjobëvënie. Ndërsa dje, u vendos që seanca gjyqësore për konkluzionet e mbrojtjes të shtyhet për në 23 tetor. Ata pritej të paraqisnin mbrojtjen pas leximit të pretencës nga prokuroria. Seanca u shty, pasi mësohet se avokatët nuk kishin përgatitur mbrojtjen. Të martën e kaluar, Prokuroria e Krimeve të Rënda shpalli pretencën duke kërkuar 64 vite burgim në total për grupin Shullazi. Në atë seancë, organi i akuzës përfaqësohej nga prokurorët: Gentian Osmani, Anton Martini dhe Besnik Muçi. Prokuroria kërkoi 17 vjet burgim për Emiljano Shullazin, 15 vjet burgim për Gilmando Danin, nga 11 vjet burgim për Endri Zelën dhe Endrit Qyqen dhe 10 vjet burgim për Blerim Shullazin. Ndërkohë që në sallë ndodheshin dhe përfaqësues të ambasadës amerikane. Të akuzuarit kërkuan që të përfaqësohen nga avokatët e tyre në seancë, pa marrë vetë pjesë atje. Seanca u shoqërua me debate mes mbrojtjes dhe akuzës për leximin e pretencës ndaj të pandehurve. Ashtu sikurse edhe herën e mëparshme, seanca u zhvillua nën masa të rrepta sigurie, me forca të shtuara policore e me antiplumb, brenda dhe jashtë sallës.

### Ngjarja në Fushë-Krujë, policia shoqëron 16 persona me precedentë penalë

# Shpërthimi me tritol, forcat speciale 'blindojnë' banesën e Xhisiela Malokut



Policia te banesa e Xhisiela Malokut

**FUSHË -KRUJË**

Një ditë pas shpërthimit me tritol në oborrin e shtëpisë së gjyshit të Xhisiela Malokut, policia dhe FNSH kanë zbarkuar menjëherë në terren duke "blinduar" hyrjen e banesës në fshatin Larushk të Fushë -Krujës. Dy efektivë të forcave speciale qëndrojnë para hyrjes së shtëpisë së Ramazan Muçës, ku jeton Xhisiela, ndërsa mbajnë në monitorim çdo lëvizje të dyshimtë. Një furgon policie, me një tjetër efektiv brenda saj janë stacionuar pranë banesës. Të afërmit e 25-vjeçares janë marrë në mbrojtje pas shpërthimit që ndodhi mesnatën e së dielës në oborrin e banesës. Ndërsa, Xhisiela


Xhisiela Maloku

Maloku vijon t'ua besojë sigurinë e saj njerëzve të Rexhep Rrajës siç deklaroi dy ditë më parë. Edhe njerëzit që kërkojnë të vizitojnë familjen e Ramazan Muçës shoqërohen nga efektivët e policisë. Ndër-kaq, policia ka shoqëruar në komisariat 16 persona, të cilët janë me precedentë penalë. Plani i masave vjen pas shpërthimit të eksplozivit në shtëpinë e 25-vjeçares, rasti i së cilës ka trazuar kohët e fundit politikën shqiptare dhe mediat, pasi denoncoi të dashurin e saj, djalin e deputetit të PS-së, Rrahman Rraja për dhunë dhe më pas u tërhoq nga ky denoncim.

**SHPËRTHIMI ME TRITOL**

Dy ditë më parë, burime zyrtare nga policia bënë me dije se eksplozivi (rreth 100 gr) është hedhur nga rruga drejt cepit të oborrit të përbashkët të banesave të Besim Muçës dhe Ramazan Muçës (ky i fundit gjyshi nga nëna i Xhisiela Malokut) rreth orës 23:30 të së dielës, por fatmirësisht si pasojë e shpërthimit nuk ka pasur të lënduar dhe as dëme materiale. Paralajmërimi me tritol është bërë ndaj banesës së gjyshit të Xhisielës, ku kjo e fundit jeton së bashku me nënën dhe motrën. Menjëherë pas sinjalizimit për shpërthimin në fjalë, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Pas sulmit me tritol, Xhisiela Maloku si dhe të afërmit e saj janë marrë në mbrojtje nga policia. Ndërkohë, vetë Xhisiela në një prononcim për mediat, tha se gjithçka është bërë nga PD dhe opozita dhe se ajo nuk është e kërcënuar nga fisi Rraja. "Unë jam Xhisiela dhe të vërtetën e di unë dhe vetëm unë dhe askush nuk mund të hedhë hipoteza. Deri dje nuk isha e rrezikuar, tashmë mendoj se ndihem e rrezikuar nga opozita. Deri dje mbrojtjen nuk e kam pranuar se nuk kam qenë e kërcënuar. Unë isha në shtëpi kur u hodh eksplozivi. Patjetër që u tremba, ishte një shpërthim i fuqishëm, por tani nuk do të trembem sepse gjithçka bëhet që unë të kërkoj azil, të fajësoj njerëz të pafajshëm. Unë nuk do të kërkoj azil, sepse nuk do të largohem nga Shqipëria", tha 25-vjeçarja.

S4J
Aftësi për Punë / Skills for Jobs

REQUEST FOR PROPOSAL

Swisscontact is an independent Swiss foundation promoting economic, social, and environmental development. Swisscontact's objective is to open up pathways out of poverty for people in developing countries through broad-based economic development. In its various projects Swisscontact facilitates access to skills development programmes, fosters competitive entrepreneurship, creates access to local financial services, and promotes sustainable use of resources.

The "Skills for Jobs Project" (S4J) aims to contribute to developing Albania into a more competitive economy and a socially inclusive society, by improving and increasing vocational education.

One important part of this project is to improve quality of formal Vocational Education and Training (VET) by introducing new ways of inclusive learning (NWoIL), including the use of technologies like virtual learning platforms, mobile devices or social media. 49 teachers from six schools in five regions have received extensive training and have participate in developing NWoIL in their schools. 3209 students and 255 teachers have been enrolled, in partner schools, in July 2018, 367 students and 76 teachers were active users.

In the framework of the Skills for Jobs project, Swisscontact seeks to realize the procurement object: "Develop and support the implementation of a Moodle based VLP and VTC Management Information System".

Swisscontact, invites interested candidates to bid for the realization of the procurement object, according to the Request for Proposal.

For more detailed information, please visit the following website:
https://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html

## Makina me 118 kg drogë kalon në Qafë-Botë, kapet në Igumenicë



**GREQI** - Polica greke ka sekuestruar dje 113 kg marijuanë në Igumenicë, që thuhet se vinte nga Shqipëria. Ndërkaq, mësohet se në pranga ka përfunduar një shtetas grek, i cili drejtonte mjetin. Ky i fundit kishte lënë territorin shqiptar nga dogana e Qafë-Botës, ndërkohë që u ndalua në Igumenicë. "Pas informacioneve në rrugë operative, sot me 09.10.2018, në vendin e quajtur Rajo, Igumenicë, është ndaluar një mjet që drejtohej nga një shtetas grek 48-vjeç. Në një vend të improvizuar enkas brenda mjetit, konkretisht poshtë kabinës së pasagjerëve, me ndihmën e qenit nuhatës u gjetën dhe u sekuestruan 113 pako me 115 kg 962 gr marijuanë. U sekuestruan, gjithashtu, edhe 2 telefona celularë"- thuhet në deklaratën e policisë greke.

### I plagosuri për komandon: "Kokëmadhi" do kishte vdekur, nëse nuk do ndërhyja unë

# "Mollë sherri" për masakrën në ish-Bllok, shpallet në kërkim këngëtarja Elvana Gjata

## *Ervis Martinaj në gjykatë: Këngëtarja nuk ka lidhje fare. Ervin Mata është një dele, ka frikë, por do flas me babin e tij*

Trëndafile Visha

TIRANË

Këngëtarja e njohur Elvana Gjata, e cilësuar si "mollë sherri" për masakrën e ndodhur mbrëmjen e 4 tetorit në lokalin "Monopol", ku mbeti i vrarë 28-vjeçari Fabian Gaxha dhe u plagosën dy të tjerë është shpallur në kërkim nga policia. Mësohet se prokuroria ka urdhëruar shoqërimin e detyrueshëm të këngëtares, e cila ishte në lokalin ku ndodhi ngjarja vetëm 20 minuta para krimit. Shpallja në kërkim policor e detyron Gjatën që të paraqitet për të dhënë shpjegime brenda 30 ditëve, pasi duhet të japë deklarimet e saj për ngjarjen e rëndë që tronditi kryeqytetin. Në të kundërt, do të bëhet shoqërimi i saj i detyruar. Pas sherrit në ish-Bllok, ku u përfshi edhe i dashuri i saj, Ervin Mata, këngëtarja shqiptare u largua nga Shqipëria më 5 tetor, vetëm pak orë pas ngjarjes. Ajo është larguar nga Rinasi drejt një vendi të BE-së, ndërkohë që nuk dihet vendndodhja e saj. Mësohet se Elvana Gjata, i dashuri i saj, Ervin Mata; Fabian Allushi dhe Mevjol Bilo, (të tre të shpallur në kërkim) kanë qenë të ulur në një tavolinë, ndërsa kanë nisur konfliktin me palën tjetër ku ishte viktima. Personi i dyshuar për vrasjen e Fabian Gaxhës dhe plagosjes së Ervis Martinajt e Eljon Hatos pohohet se është truproja dhe kushëriri i këngëtares Gjata, njëherësh edhe pjesë e Forcave Komando ushtarake, Mevjol Bilo. Ngjarja me 1 të vrarë e dy të plagosur "kryqëzoi" këngëtaren Elvana Gjata, ndërkohë që i plagosuri Ervis Martinaj gjatë dëshmisë së tij para trupit gjykues që vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj tij ka deklaruar se me "Fabin vriteshe edhe për një shikim. Këngëtarja nuk ka lidhje fare". Pak ditë pas masakrës në ish-Bllok, "Gazeta Shqiptare" ka siguruar një pjesë të dëshmisë së 36-vjeçarit. Ndër të tjera, ai ka thënë se me Ervin Matën s'ka pasur lidhje fare dhe se me të është takuar rastësisht. "Ervin Mata është një dele. Ai tani do të jetë në një copë dhomë, duke pirë. Unë s'kam asnjë lloj konflikti me të, por do të flasë me babin e tij dhe do i them të vijë të sqarojë. Ai ka frikë se mos ngel në burg, se ju e arrestoni, e mbani kot", është shprehur Martinaj. Gjithashtu, 36-vjeçari i plagosur ka pohuar se komando Mevjol Bilo, të cilin e quan "Kokëmadhi" e qëlloi atë për refleks, ndërsa ka sqaruar se nëse nuk do të kishte ndërhyrë ai (Martinaj), komando do të kishte vdekur, pasi s'kishte mundësi të nxirrte armën.



Këngëtarja Elvana Gjata

**"DELJA"**

"Ervin Mata është një dele. Ai tani do të jetë në një copë dhomë, duke pirë. Unë s'kam asnjë lloj konflikti me të, por do të flas me babin e tij dhe do i them të vijë të sqarojë", ka thënë gjatë dëshmisë së tij në gjykatë, 36-vjeçari Ervis Martinaj.



36-vjeçari i plagosur, Ervis Martinaj

**"KOKËMADHI"**

"Me Ervin Matën s'kam pas lidhje fare. Me të jam takuar rastësisht. Unë jam rritur me babën e Ervinit. Vetëm Fabi është fajtor në këtë mes, por sherri nuk ishte aq i madh, sa për të goditur aq shumë plumba. Unë isha ai që i thashë Fabit 'mos', se po të mos kisha ndërhyrë unë, 'Kokëmadhi' do të kishte vdekur sot, pasi ai e kishte të pamundur të qëllonte se e kishin kapur nga krahët e s'kishte mundësi të nxirrte armën. Ai u tregua legen, pasi kur unë i thashë Fabit, 'mos çfarë po bën', ai gjuajti me refleks".



Vendim :Gjykata e keshilluar ne vend, duke konstatuar se nga ana e personit nen hetim u kerkua mbrojtja me avokat konform neneve 48 e 49 te K.Pr.Penale, vendosi te pranoje kerkesen e personit nen hetim qe te perfaqesohet nga avokatet Mirash Martini dhe Arian Hoxha.

Kerkesa te tjera nuk ka.

VENDIM :Gjykata ne baze te nenit 355 te K.Pr.Penale deklaron te hapur shqyrtimin gjyqesor dhe fton prokuroret te parashtrojne faktet [illegible] mbeshtetje te kerkeses objekt shqyrtimi.

Prokuroret Artan Lulaj dhe Kreshnik A[illegible] thane : [illegible] qendrojme teresisht kerkeses se paraqitur, lexojne kerkesen per [illegible] perfundimisht kerkojne:
-Vleftesimin e ligjshem te arrestit [illegible] te bere ndaj personit nen hetim Ervis Martinaj .
-Caktimi i mases [illegible] per kete shtetas ate te " Arrest ne shtepi".

-Kerkesen [illegible] ne provat qe i perkasin procedimit penal ne ngarkim te shtetasit Ervis Martinaj dhe konkretisht ato bashkangjitur kerkeses, gjithsej [illegible]

Personi nen hetim tha : Une si puna e atyre dy cunave njoh te gjithe Tiranen.Ne kete ngjarje kane qene pale ne konflikt dy persona qe kane hyre nga jashte .Personat qe kane qene te pranishem fillimisht ne lokal nuk kane lidhje me [illegible] pija me Ervin Maten dhe Redin kane hyre dy persona nga jasht[illegible] tyre e njoh ,quhej Fabi ndersa tjetrin nuk e njoh dhe ata te dy [illegible]



-Gjykata pyet personin nen hetim :Por kur ti e njihje......

Personi nen hetim tha:Fabi ka qene shume problematik ,edhe para disa muajsh kishte bere veprime te tilla dhe per kete arsye une nuk e afroja ne miqesi pasi ishte shume konfliktual .Ai para 5 muajsh ishte diagnostikuar me kancer dhe sipas mjekeve atij i kishte ngelur edhe shume pak muaj jete.Kjo vertetohet edhe me raportet ,pasi ai nuk ishte mire nga mendte kohet e fundit.Kete gje e verteton edhe dr.Petrela .Ai ishte cuni i dajes tim por ishte shume konfliktual dhe kishte bere disa konflikte rresht.Me Fabin vriteshe edhe per nje shikim .Kengetarja ska lidhje fare.

Gjykata pyet personin nen hetim :Ju e kishit lene me Maten [illegible]
Personi nen hetim tha :Me Ervin Maten skam pas [illegible] jam takuar rastesisht .Une jam rritur me baben e Ervin .Vetem Fa[illegible] ne kete mes ,por sherri nuk ishte aq i madh sa per te goditur [illegible] Une isha ai qe i thashe Fabit mos se po te mos kisha nderhy[illegible] do te kishte vdekur sot pasi ai e kishte te pamundur qe te qellon[illegible] kapur nga krahet e skishte mundesi te nxirrte armen.Por [illegible] pasi kur une i thashe Fabit mos cfare po ben ,ai gjuajti me [illegible] Fabi gjalle dhe nipcja ime nuk do te kishte vdekur se ai i vdek[illegible] Jeni [illegible] rene ne qafe kot pasi une isha duke pire nje gote . Une ne spital kam shk[illegible] vete me nje taksi ,nese nuk do te kisha shkuar per tre minuta do te kisha vdekur pasi kisha humbur 2.5 litra gjak.
Gjykata pyet personin nen hetim :Dy personat u konfliktuan me sy para se te hynin nga jashte ?
Personi nen hetim tha:TaniErvin Mata eshte dele ,ai tani do jete ne nje cope dhome duke pire ,une nuk kam asnje lloj konflikti me te por une do flas me babin e tij dhe do [illegible] te sqaroje .Ai ka frike se mos ngel nme burg se ju te arrestoni e mbani [illegible]

[illegible] personin nen hetim :Po qelloi Fabi me arme?
[illegible] hetim tha:Mendoj se Fabi nje here ka gjuajtur ne ajer.

Faksimile e dëshmisë së dhënë në gjykatë nga Ervis Martinaj

**"NIPÇJA"**

"Kur ata po konfliktoheshin, unë jam futur në mes për t'i ndarë dhe besoj që jam plagosur pa dashje nga 'Kokëmadhi'. Ai më gjuajti me refleks, pasi nëse ai do donte të më vriste, i kishte të gjitha mundësitë, pasi unë në tokë i shtrirë isha. Nipçja në ato momente (Elion Hata), i cili ishte në tavolinë me mua i tha 'Kokëmadhit': 'Mos çfarë bëre, t'u thafshin krahët' dhe ai në këto momente është goditur. Vetëm oficeri i komandës ka qëlluar".

### DËSHMIA E ERVIS MARTINAJT

Gjykata ka pyetur mjeken e pranishme nëse personi nën hetimi (Martinaj) është në gjendje për të folur. Mjekja është përgjigjur se është në gjendje për të folur. Ndërsa vetë Martinaj ka thënë: "Po, mund të flas, thjesht qafën kam të paralizuar". Më pas 36-vjeçari nën hetim ka dëshmuar për ngjarjen: "Unë, si puna e atyre dy çunave njoh gjithë Tiranën. Në këtë ngjarje kanë qenë palë në konflikt dy persona që kanë hyrë nga jashtë. Personat që kanë qenë të pranishëm fillimisht në lokal nuk kanë lidhje me ngjarjen. Kur unë po pija me Ervin Matën dhe Redin kanë hyrë dy persona nga jashtë lokalit. Njërin prej tyre e njoh, quhej Fabi, ndërsa tjetrin nuk e njoh dhe ata të dy kanë pasur konflikt me një tavolinë tjetër. Të gjithë të tjerët në lokal i kam miq dhe s'kam pasur asnjë konflikt me ta. Kur ata po konfliktoheshin, unë jam futur në mes për t'i ndarë dhe besoj që jam plagosur pa dashje nga "Kokëmadhi". Ai më gjuajti me refleks, pasi nëse ai do të më vriste, i kishte të gjitha mundësitë, pasi unë në tokë i shtrirë isha. Nipçja në ato momente (Elion Hata), i cili ishte në tavolinë me mua i tha 'Kokëmadhit': 'Mos, çfarë bëre, t'u thafshin krahët' dhe ai në këto momente është goditur. Vetëm oficeri i komandës ka qëlluar. Unë u hodha në mes, isha me gotë vere në dorë për të qetësuar situatën. Unë e njoh Fabin, kisha 4 muaj pa e parë". Gjatë dëshmisë së tij, Ervis Martinaj ka folur për viktimën Fabian Gaxhajn, për të cilin është shprehur se ishte shumë problematik dhe për këtë arsye nuk e afronte në miqësi. "Ai para 5 muajsh ishte diagnostikuar me kancer dhe sipas mjekëve, atij i kishin ngelur edhe shumë pak muaj jetë. Kjo vërtetohet edhe me raportet, pasi ai nuk ishte mirë nga mendtë kohët e fundit. Ai ishte çuni i dajës tim, por ishte shumë konfliktual dhe kishte bërë disa konflikte rresht. Me Fabin vriteshe edhe për një shikim. Këngëtarja s'ka lidhje fare", ka pohuar Martinaj.

I pyetur nga gjykata nëse e kishte lënë me Matën për t'u takuar, Ervis Martinaj ka deklaruar: "Me Ervin Matën s'kam pas lidhje fare. Me të jam takuar rastësisht. Unë jam rritur me babën e Ervinit. Vetëm Fabi është fajtor në këtë mes, por sherri nuk ishte aq i madh sa për të goditur aq shumë plumba. Unë isha ai që i thashë Fabit 'mos' se po të mos kisha ndërhyrë unë, 'Kokëmadhi' do të kishte vdekur sot, pasi ai e kishte të pamundur të qëllonte se e kishin kapur nga krahët e s'kishte mundësi të nxirrte armën. Ai u tregua legen, pasi kur unë i thashë Fabit, 'mos çfarë po bën', ai gjuajti me refleks. Do të ishte Fabi gjallë dhe nipçja ime nuk do të kishte vdekur, se ai i vdekur është. Jeni duke rënë në qafë kot, pasi unë isha duke pirë një gotë. Unë në spital kam shkuar vetë me një taksi. Nëse nuk do të kisha shkuar për 3 minuta, do të kisha vdekur, pasi kisha humbur 2.5 litra gjak". I pyetur nga gjykata se dy personat u konfliktuan me sy para se të hynin në lokal, personi nën hetim (Martinaj) tha: "Ervin Mata është një dele. Ai tani do të jetë në një copë dhomë, duke pirë. Unë s'kam asnjë lloj konflikti me të, por do të flas me babin e tij dhe do i them të vijë të sqarojë. Ai ka frikë se mos ngel në burg, se ju e arrestoni, e mbani kot".

**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C**

Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C
*-Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane* **.Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Leke.**

Data e shpalljes 11.09.2018
Data e zhvillimit 11.10.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

**Më datë 19 nëntor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00** tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e pasurisë "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës.
Prona përbëhet nga dy dyqane (gjithsej rreth 245 m2) dhe tre apartamente (gjithsej rreth 245 m2) dhe mbi këto prona nuk rëndon barrë hipotekore apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera.

Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 37800 lek/m2, ndërsa çmimi fillestar për dyqan do të jetë 56700 lek/m2.
**Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644**

Publikohen emrat që do të vlerësohen edhe në Logopedi, Imazheri e Teknik Laboratori

# Provimi/ Listat e plota të kandidatëve në Infermieri, Fizioterapi e Mami

## *Urdhri i Infermierit, test mbi aftësitë profesionale*

Valentina Madani

Urdhri i Infermierit të Shqipërisë ka shpallur emrat e të gjithë studentëve që duhet të japin provimin mbi vlerësimin e aftësimit profesional. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listat me kandidatët që do i nënshtrohen në data të përcaktuara provimit VAP në 6 degët e mjekësisë. UISH njofton se ky testim do të kryhet për të vlerësuar aftësitë që këta kandidatë kanë fituar gjatë praktikës në profesionet Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknik Laboratori, Teknik Imazherie dhe Logopedist. "Ju bëjmë me dije se në ditën e provimit duhet të keni me vete kartën e identitetit, një përparëse të bardhë dhe kartën e praktikantit. Provimi do të zhvillohet në zyrat e UISH në Tiranë, tek Dispanceria", - thuhet në njoftimin e Urdhrit të Infermierit. Përkatësisht janë 427 kandidatë që do të testohen në Infermieri në datat 17-23 tetor të këtij viti. Ndërsa, në datën 16 të këtij muaji, 95 kandidatë do të vihen përballë testit në Fizioterapi e 40 kandidatë për degën Mami. Ndërkaq, 32 kandidatë në degën Teknik Laboratori, 25 në degën Teknik Imazherie dhe 14 kandidatë në Logopedi do i nënshtrohen provimit VAP në datën 16 tetor. Gjatë vitit 2012, Urdhri i Infermierit ndryshoi kushtet për të gjithë kandidatët që dëshironin të hynin në provimin e shtetit. Sipas këtyre ndryshimeve, të interesuarit, përveç praktikës profesionale, i nënshtrohen një testimi profesional në fund të saj, ndërkohë që vetëm nëse vlerësohen pozitivisht në të, kanë të drejtë të regjistrohen për provimin e shtetit. Konkretisht, studenti i diplomuar në programet e studimit të sipërpërmendura, ditën që regjistrohet, merr librezën e praktikës profesionale. Në këtë librezë mbahen shënimet ditore përgjatë 12 javëve që studenti realizon praktikën, të cilat firmosen çdo ditë nga drejtuesi i saj. Në fund, libreza e firmosur nga drejtuesit vlerësohet me një numër pikësh të caktuara. Saktësisht, ato janë nga 10 deri në 25 pikë, të cilat i njihen kandidatit gjatë realizimit të testimit profesional. Ai e merr librezën dhe 10 ditë para datës së provimit e dorëzon atë pranë Urdhrit Profesional dhe regjistrohet për dhënien e testimit profesional.

## LISTAT E PLOTA

**INFERMIER VAP TETOR 2018 DATA 17 TETOR ORA 12.00**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Kodi |
|---|---|---|---|
| 1 | ADA | AGOLLI | 0070805 |
| 2 | ADELA | LIÇE | 0060363 |
| 3 | ADELA | KARAI | 00411712 |
| 4 | ADELAJDA | XHEPA | 0050764 |
| 5 | ADELINA | ALLA | 30815 |
| 6 | ADIL | RESULI | 0120998 |
| 7 | AIDA | HABILAJ | 0120908/1 |
| 8 | AIDA | KADIQI | 30646 |
| 9 | ALBINA | BIZGJONI | 0116179 |
| 10 | ALBINA | HAKA | 0116147 |
| 11 | ALBINA | SHAHAJ | 0120993 |
| 12 | ALDA | POKA | 0115413 |
| 13 | ALDO | KADIU | 30792 |
| 14 | ALEKS | NDOU | 0116305 |
| 15 | ALEKS | NDOU | 0116305 |
| 16 | ALEKSANDRA | DOBRO | 0060360 |
| 17 | ALEKSANDRA | BALAJ | 0120983 |
| 18 | ALFREDO | BERATI | 00411859 |
| 19 | ALGIDA | MUKA | 30791 |
| 20 | ALKETA | SHASKAJ | 0120909/1 |
| 21 | AMARILDA | QATO | 0010347 |
| 22 | AMARILDA | MALAJ | 0050847 |
| 23 | AMBRA | SHURDHA | 0115681 |
| 24 | AMBRA | LLOMI | 0070854 |
| 25 | AMELA | BASHLLARI/MIMINI | 0070391 |
| 26 | ANA | LUZI | 001 |
| 27 | ANA | AVDI | 0120987 |
| 28 | ANDI | KALIVACI | 0051002 |
| 29 | ANDIOLA | MADHI | 0115816 |
| 30 | ANGJELINA | MUHARREMI | 0020332 |
| 31 | ANILA | SPAHIU | 30786 |
| 32 | ANITA | METOLLARI | 0010758 |
| 33 | ANITA | NDONI | 0115579 |
| 34 | ANTONELA | KAÇORRI | 0115570 |
| 35 | ANTONELA | MUHAMETI | 0120843/1 |
| 36 | ANUELA | PRIFTI | 0121004 |
| 37 | ANXHELA | TROKA | 0116293 |
| 38 | ANXHELA | AGAÇI | 0115631 |
| 39 | ANXHELA | LEZI | 0010708 |
| 40 | ANXHELA | TOSKA | 0116302 |
| 41 | ANXHELA | DERVISHI | 0115464 |
| 42 | ANXHELA | CEPAJ | 0120978 |
| 43 | ANXHELA | KANAJ | 0120984 |
| 44 | ANXHELINA | KARAJ | 00411843 |

**INFERMIER VAP TETOR 2018 DATA 18 TETOR ORA 08.30**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Kodi |
|---|---|---|---|
| 45 | ANXHELINA | EDRA | 0070888 |
| 46 | ANXHELINA | MEKA | 0070797 |
| 47 | ANXHENTILA | KOLA | 00411551 |
| 48 | ARBA | MILUSHI | 30767 |
| 49 | ARBEN | AVDYLI | 0115355 |
| 50 | ARBEN | TUSHA | 30810 |
| 51 | ARBI | ZELO | 0050986 |
| 52 | ARDIT | VELO | 0120964 |
| 53 | ARDIT | XHAKJA | 0116192 |
| 54 | ARDIT | QOSE | 0115638 |
| 55 | ARDIT | HOXHAJ | 0051032 |
| 56 | ARENA | LAZE | 30788 |
| 57 | ARETA | MULLA | 0120825/1 |
| 58 | ARILDO | MECO | "0050989 |
| 59 | ARJET | BALAJ | 010894 |
| 60 | ARJOLA | SHKOZAJ | 0010741 |
| 61 | ARJOLA | HABILALIAJ | 0121008 |
| 62 | ARJONA | PUTRO | 0010596 |
| 63 | ARLEN | DEMIRI | 0116057 |
| 64 | ARMANDO | DOSARI | 0010734 |
| 65 | ARMELA | TOSKA | 0116282 |
| 66 | ARMELA | SULO | 0010753 |
| 67 | ARSEN | ZIA | 0116174 |
| 68 | ARSENA | LLESHI | 00411634 |
| 69 | ARTAN | ÇALI | 0115941 |
| 70 | ARTEMISA | DOBRA | 00411724 |
| 71 | ARTIOLA | SHPATAJ | 30823 |
| 72 | ARTUR | NOGU | 0115964 |
| 73 | AVENIR | HOXHA | 0101011 |
| 74 | BEHIJE | HOXHA | 0010689 |
| 75 | BEKIM | GJOSHI | 0115222 |
| 76 | BESMIR | LLUPA | 0116199 |
| 77 | BESMIRA | LAMI( DEMIRI) | 30830 |
| 78 | BESMIRA | ALMUCA | 30427 |
| 79 | BLEONA | RAMSALIU | 30824 |
| 80 | BLERIM | MALOKU | 30809 |
| 81 | BLERIM | KOPAÇI | 0116171 |
| 82 | BLERINA | BERISHA | 00411148 |
| 83 | BLERINA | ZYFI | 0070884 |
| 84 | BLERTA | MECKA | 0080311 |
| 85 | BORA | BREGU | 0010597 |
| 86 | BORA | LEKA | 30659 |
| 87 | BORALDA | ALLIU | 00411723 |
| 88 | BRISELDA | MELISHTE | 00411756 |

**INFERMIER VAP TETOR 2018 DATA 18 TETOR ORA 11.00**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Kodi |
|---|---|---|---|
| 89 | BRISELDA | TANASICA | 0115308 |
| 90 | BRISILD | HAXHIRAJ | 0116316 |
| 91 | BRISILDA | HOXHA | 0020333 |
| 92 | BRISILDA | BUSHATI | 0020334 |
| 93 | BRIXHILDA | BRASHA | 0116311 |
| 94 | BRUNA | ABATI | 30801 |
| 95 | BRUNILDA | VASA | 0090328 |
| 96 | BRUNILDA | DOLLANI (QEFA) | 0051005 |
| 97 | BRUNSILDA | SHABANAJ | 0120937/1 |
| 98 | BUKUROSHE | FERATI | 0116073 |
| 99 | BUKUROSHE | FERATI | 30802 |
| 100 | ÇERÇIZ | SULAJ | 0115590 |
| 101 | DAJANA | BARDHI | 0115508 |
| 102 | DALINA | LAME (MURIZI) | 0070949 |
| 103 | DANINA | SELITA | 0115585 |
| 104 | DARIAN | RISTA | 0116058 |
| 105 | DEA | SADIKU | 0116084 |
| 106 | DENADA | BREGU | 0070633 |
| 107 | DENIS | MEMA | 0070960 |
| 108 | DENIS | GJOSHI | 30808 |
| 109 | DENISA | MYRTA | 0115825 |
| 110 | DENISA | XHAFERAJ | 0060358 |
| 111 | DENISA | MALAJ | 0120982 |
| 112 | DENISA | BAKU | 0112780 |
| 113 | DENISA | PAJO | 0051076 |
| 114 | DENISA | MALAJ | 80283 |
| 115 | DENISA | CIKALLESHA | 30832 |
| 116 | DHIMITER | PRIFTI | 0010756 |
| 117 | DHIMITRAQ | SHEQI | 0010757 |
| 118 | DHOKSIANA | KOLA | 0010695 |
| 119 | DORINA | REFATI | 0114128 |
| 120 | DORINA | HASANI | 0120928 |
| 121 | DORINA | MATO | 0070731 |
| 122 | DORIS | JONUZAJ | 0120972 |
| 123 | DRILON | KAMISHI | 0116230 |
| 124 | EART | CACI | 0120996 |
| 125 | EDIOLA | PERSHQEFA | 0120969 |
| 126 | EDJOLA | LAHE | 0060359 |
| 127 | EDJONA | RISTA | 0010746 |
| 128 | EDMIRA | KAPLLANAJ | 0115519 |
| 129 | EDUARD | META | 00411858 |
| 130 | EDUARD | REZHDA | 0070962 |
| 131 | EDUART | ISMAILI | 0116320 |
| 132 | EFTALIA | SOPAJ | 0080397 |

**INFERMIER VAP TETOR 2018 DATA 18 TETOR ORA 13.00**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Kodi |
|---|---|---|---|
| 133 | ELDA | SHAHINAJ | 0120970 |
| 134 | ELDA | DURAKU | 0101002 |
| 135 | ELDI | MUHAJ | 0051073 |
| 136 | ELDISA | HYSA | 0051080 |
| 137 | ELFRIDA | SHAIPI | 00411533 |
| 138 | ELFRIDA | SHAIPI(SHERMADHI) | 00411533 |
| 139 | ELIONA | HAJDARAJ | 0115311 |
| 140 | ELIONES | LALAJ | 0120675/1 |
| 141 | ELISA | ZERJA | 0020328 |
| 142 | ELISABETA | KAMBERI | 80362 |
| 143 | ELIZABETA | KASA | 30833 |
| 144 | ELMA | XHINDI | 0116248 |
| 145 | ELONA | BLLIKU(BETI) | 00411861 |
| 146 | ELSJON | GOLECI | 30811 |
| 147 | ELVI | SOTA | 0116321 |
| 148 | EMA | NASI | 0120980 |
| 149 | EMANUELA | HOXHA | 0120836/1 |
| 150 | EMERILDA | DOMI | 0121001 |
| 151 | EMILJANO | COTA | 0070814 |
| 152 | ENDRI | RROSHI | 0050943 |
| 153 | ENDRIT | AGALLIU | 0010755 |
| 154 | ENERJADA | SHAHINAJ | 0114431 |
| 155 | ENGJEGJUSHE | BAJRAMI | 0051066 |
| 156 | ENGLAND | BIÇAKU | 00411642 |
| 157 | ENIGERT | KOCI | 0120886/1 |
| 158 | ENISA | CENA | 0020336 |
| 159 | ENKELA | KURTI | 0116292 |
| 160 | ENKELA | MURATAJ | 114143 |
| 161 | ENKELEDA | REÇI | 0020337 |
| 162 | ENKELEDA | PREÇI | 0060356 |
| 163 | ENRIK | PAPA | 0010747 |
| 164 | ENSUIDA | MUSA (BALO) | 0051078 |
| 165 | ENTELA | SUKTHI | 0114742 |
| 166 | ENTELA | IMERAJ | 0120973 |
| 167 | ENTJOLA | METHASA | 00411654 |
| 168 | ENXHI | NDREKA | 0116096 |
| 169 | ERALDA | ÇELMETA(SULA) | 00411618 |
| 170 | ERGENA | OSJA (DANI) | 0100883 |
| 171 | ERGEST | NAÇI | 0116029 |
| 172 | ERI | DEMIRI | 0070779 |
| 173 | ERIDION | QEJVANAJ | 0050901 |
| 174 | ERIDON | HYSA | 30787 |
| 175 | ERILDA | LIÇI | 00411568 |
| 176 | ERISA | ALUSHI | 0115805 |

**INFERMIER VAP TETOR 2018 DATA 22 TETOR ORA 08.30**

| Nr. | Emri | Mbiemri | Kodi |
|---|---|---|---|
| 177 | ERISA | ÇEPELE | 0115634 |
| 178 | ERISELDA | ISUFAJ | 0051069 |
| 179 | ERISELDA | AVDIU | 0051021 |
| 180 | ERMIRA | BAÇI | 0116222 |
| 181 | ERMIRA | DULEVIC | 0120915/1 |
| 182 | ERNEST | MARKAJ | 0115605 |
| 183 | ERVIN | KËNAÇI | 0116284 |
| 184 | ESMARILDA | MBOLANI | 0010633 |
| 185 | ESMERALDA | ZENELI | 0090276 |
| 186 | ESMERALDA | HYSENAJ | 0050891 |
| 187 | ESMERALDO | PAZAJ | 0120943/1 |
| 188 | EVA | QALLIAJ | 0115547 |
| 189 | EVA | MUHAJ | 0120968 |
| 190 | EVISA | KORICA | 0010748 |
| 191 | FABRIELA | METUSHI | 0120863/1 |
| 192 | FATIME | MERKAJ | 0116211 |
Në kremtimet e 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Fondacion Arsimor Kulturor Humanitar – ALSAR dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" promovojnë sot botimit anastatik të revistës së mirënjohur kulturore e shkencore "Diturija"(1909-1927). Më këtë rast, sot mbahet edhe një konferencë shkencore, kushtuar kontributit të themeluesit të saj të shquar Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës "Diturija". Në konferencë, Prof. Dr. Xhevat Lloshi do të flasë për çështjet gjuhësore në revistën "Diturija" pas Kongresit të Manastirit, Prof. Dr. Luan Malltezi për sfidat e botimit të "Diturisë", Prof. Dr. Persida Asllani për revistën e Lumo Skendos dhe misionin e dijes, Prof. Mark Marku për revistën në historinë e shtypit dhe shoqërisë shqiptare dhe Uran Butka për punën e bërë për botimin veprën e Mid'hat Frashërit.

**REVISTA**

Revista "Diturija" u themelua nga Lumo Skëndo (pseudonim letrar i Mid'hat Frashërit) menjëherë mbas përfundimit të Kongresit të Manastirit, kryetar i të cilit u zgjodh njëzëri 110 vjet më parë. Numri i saj i parë doli në Selanik më 1 janar të vitit 1909 dhe qysh në fillim spikati me frymën e thellë kulturore dhe informacionin diturор që do të rrugëtonte së bashku me revistën drejt një enciklopedie të mirëfilltë albanologjike. Pavarësisht mbylljes së saj mbas një viti, Lumo Skëndo e vijoi projektin e tij duke e botuar tri vite me radhë në Tiranë 1926-1929 (përveç 3 numrave që botoi në Bukuresht më 1916 që autori i konsideroi të humbur).

Nga përcaktimi "E përkohshme shqip literare dhe diturake" më 1909, revista do të shkojë drejt formulimit "E përkohshme shqiptare" (1926) pikërisht sepse thelbi i saj ishte dija mbi kombin, që për themeluesin e saj do të thoshte dashuri e pakushtëzuar për dijen e mbrujtur me dashurinë e pakushtëzuar për atdheun. "Diturija" e Lumo Skëndos shfaq simbiozën e rrallë të nocionit të dijes, diturimit dhe atij universal të atdheut. Ajo e lidh njeriun individual me tërësinë e entitetit kombëtar, përmes të cilit ai shndërrohet në "njeriun në botë", në qenien universale.

Revista "Diturija" mbetet shprehja më e plotë e profilit intelektual të Lumo Skëndos. Në të ai zhvilloi linja të gjera studimore duke ndërtuar korpus të mirëfilltë albanologjik në çështje të historisë, të udhëpërshkrimeve, të dëshmive, të gjuhësisë shqipe e drejtshkrimit, të bibliografisë etj. Ndër to spikasin cikli "Udhëtarët e huaj në Shqipëri", rubrikat "Shtim në rradhojtë e Legrandit", "Duke lexuar një libër", "Tribuna gramatike dhe gjuhësijë", biografi të shumta, vëzhgime zakonore, dëshmi historike si dhe shkrime me interes të veçantë mbi historinë e besimeve dhe kultit ndër shqiptarë etj.

Botimi anastatik i saj në prag të 110–vjetorit të Kongresit të Manastirit sjell në vëmendje faktin se për nga rëndësia e dijes që ajo përcolli "Diturija" është tashmë në një monument kulture, themelet e të cilit u hodhën në vitin e largët 1909 për t'u shndërruar në ngrehinën madhështore të dijes dhe "bujarisë së dijes" gjatë viteve 1926-1929. Bashkë me '*Albaninë*' e Konicës dhe me plejadën e simotrave të saj gjatë viteve '20-'40 të shekullit të kaluar (*Hylli i Dritës, Zani i naltë, Leka, Shkëndija, Përpjekja shqiptare, Minerva)* këto revista përbëjnë një nga entitetet themelore të kulturës së shkruar shqipe.

Ky botim vjen si frut i bashkëpunimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë me Fondacionin ALSAR si dhe me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, e cila do të mirëpresë në Prishtinë në javët e ardhshme promovimin dhe konferencën kushtuar "Diturisë" dhe themeluesit të saj Lumo Skëndo.

Ky botim anastatik u organizua në dy vëllime të hijshme: Vëllimi I: janar 1909 – tetor 1927 dhe Vëllimi II nëntor 1927 – dhjetor 1929.

Natyra anastatike e tij sjell në të tashmen tonë vullnetin e autorit, botuesit, pse jo edhe shijen, finesat apo trillet e tij njerëzore. Por mbi të gjitha mundëson një lexim tërësor, një rrokje të plotë të të gjithë koleksionit të çmuar të "Diturisë" si për lexuesin e pasionuar ashtu dhe për studiuesin e ardhshëm të një prej personaliteteve dhe të një prej veprave më monumentale të jetës kulturore e shkencore kombëtare.

**ESHTRAT E MIT'HAT FRASHËRIT**

Qeveria shqiptare ka marrë



vendimin për kthimin në atdhe të eshtrave të Mid'hat Frashërit, patriotit, personalitetit të shquar të kulturës e të letrave shqipe, firmëtarit të pavarësisë dhe kryetarit të Kongresit të Manastirit. Eshtrat e personalitetit të shquar do të kthehen në atdhe gjatë javës përkujtimore të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, me një ceremoni shtetërore që do të mbahet nga 14-22 nëntor 2018", sipas vendimit të qeverisë shqiptare të firmosur nga kryeministri Edi Rama. Kërkesa për kthimin e eshtrave të Mid'hat Frashërit në atdhe, ka qenë e Institutit të Studimeve "Lumo Skëndo", sipas kryetarit të këtij instituti, Uran Butka. Për ceremoninë e kthimit të eshtrave, qeveria ka akorduar edhe një buxhet shtetëror me një fond prej 3 239 400 (tre milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind) lekësh. Më 3 tetor të vitit 1949, ora 09.25 në Nju Jork, ndërroi jetë Mid'hat Frashëri, shërbestari i Shqipërisë. Sipas autopsisë që iu bë në spital, u konstatua se vdekja i ishte shkaktuar nga i infarkti miokardit. Ekziston edhe një variant i dytë i mundshëm, se infarkti i është shkaktuar nëpërmjet ilaçeve apo mënyrave të tjera nga ana e agjentëve të KGB ruse, që vepronin kundër Komitetit "Shqipëria e Lirë", me qendër në Nju Jork. Mid'hat Frashëri ishte kryetar i Komitetit "Shqipëria e Lirë" ose qeveria në mërgim, e mbështetur nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mendohet se për vdekjen e papritur të Mid'hat Frashërit ka gisht Kim Filbi, agjenti i dyfishtë, i cili ishte në Londër në shtator të vitit 1949, kur Mid'hat Frashëri shpalli Komitetin "Shqipëria e Lirë" dhe njëkohësisht Kim Filbi gjendej në Nju Jork, kur Mid'hati u vendos atje. Është e mundur që ai të jetë asgjësuar nëpërmjet Kim Filbit nga Sigurimi Sovjetik, në bashkëpunim me Sigurimin Shqiptar, ashtu siç u veprua edhe me disa personalitete antikomuniste të Lindjes si Bandera, Markov etj. Trupi i Mid'hat Frashërit u varros me nderime në Nju Jork. Një varr i thjeshtë, mes barit e luleve, me mbishkrimin e vetëm: Mid'hat Abdyl Frashëri, 1880-1949.




## KUR SCHLIEMANN TAKONTE ARVANITASIT NË ITAKËN E ODISEUT

Kur afrohesha në kasollet e fshatarëve për të blerë rrush apo për të pirë ujë, gjithnjë na suleshin qentë, por duke i gjuajtur me gurë apo duke bërë sikur po mernim ndonjë gur për t'i goditur, unë i mbaja ata larg nesh. Atë ditë në shtëpinë e fshatarit, në oborr u sulmova me furi nga katër qen të mëdhenj që nuk trembeshin nga gurët e mi. Por ai që më udhëhiqte në atë udhëtim kishte mbetur larg meje dhe në këtë situatë të vështirë m'u kujtua historia e Odiseut që kisha lexuar, i cili, kur i ishin turrur qentë, ishte ulur qetësisht dhe kishte qëndruar pa lëvizur. Dhe kështu unë ndoqa shembul-



lin e Uliksit duke mos lëvizur, edhe pse qentë ishin gati të më shqyenin, duke ardhur rrotull meje. Ata do më kishin kafshuar po të mos isha përulur, duke e zbutur kështu egërsinë e tyre…".

Sipas Luan Ramës, këtë histori, Schliemann e tregon në librin e tij "Kërkimet arkeologjike në Itakë, Peloponez e Trojë". Më tej ai vazhdon: "Pasi thirra, u shfaq një burrë shtatëdhjetëvjeçar me tipare të mira dhe sy të mëdhenj inteligjentë, me një hundë shqiponje, me flokët e gjata e të bardha si dëbora që kontrastonte me fytyrën e tij të nxirë nga forca e diellit. Studiuesi Rama shton Siç ndodh këtu, ai po vinte këmbëzbathur dhe me një fustanellë pambuku, e lidhur sipër brezit dhe qe zgjatej poshtë në njëmijë palë deri tek gjunjët. Ky kostum i shqiptarëve që e kanë adoptuar grekët që nga koha e revolucionit, ekziston në Shqipëri që nga koha e antikitetit të hershëm dhe shpesh e gjen në statujat e vjetra dhe veçanërisht të Pirros, mbretit të Epirit që ndodhet në muzeun e Napolit…".ARVANITASIT NË ITAKËN E ODISEUT

EKSPOZITA






# Nudot e portretet e Pashk Përvathit

### *Ekspozita "Ndryshe", 41 veprat që sjellin punimet e fundit të piktorit*

Fatmira Nikolli

Ekspozita personale në pikturë, e titulluar "Ndryshe", është e 41-ta për piktorin Pashk Përvathi. Është titulluar "Ndryshe", sepse në këtë ekspozite vjen me një profil tjetër të panjohur për artdashësit shqiptarë. Ekspozita përmban 46 vepra në gjininë e portretit, kompozimit figural dhe 21 nudo. I gjithë materiali artistik është realizuar në kontakt me modelin dhe dallon në trajtimin piktorik zellin e artistit Pervathi për të ruajtur identitetin e tij si piktor i penelit të gjerë, dinamik dhe dekorativ. Modelet në pjesën më të madhe janë romë, një afeksion i artistit që nga rinia e tij për t'i pikturuar.

Portretet janë zbërthyer në karakterin e tyre. Në to ndjehet pikturimi në natyrë, ajri dhe plastika e modeleve. Vlen të përmendim portretin "Romi Islam Shabani", që padyshim mbetet ndër vlerat më të mira të piktorit. Ai është mishërim i zbërthimit të karakterit dhe formës përmes një penelate të ngjeshur ngjyrë dhe ekspresiviteti.

Kompozimet figurale vijnë në zgjedhje të ndryshme kompozicionale. Piktori kërkon bukurinë hyjnore të femrës përmes një loje piktorike të ngjyrës. Mjaft të kujtojmë kompozimin "Pritja", "Bukuroshja e fjetur", "Cigania e ulur", etj. Në ekspozitë janë edhe 21 nudo. Pikërisht ky ka qenë dhe synimi i autorit. Të ekspozojë në një ekspozitë personale, realizimet e tij të dy viteve të fundit. Nudot janë zhveshura dhe gjysme të zhveshura. Janë në zgjidhje kompozicionale të ndryshme, herë me dritë natyrale e herë me dritë të brendshme të studios. Autori ka kërkuar të zbulojë përmes nudove të tij anën sensuale të femrës, bukurinë e formave trupore të saj, përmes një gjuhe artistike individuale të shfaqur gjithnjë në peizazhet e tij. Ndjehet penelata dhe ngjyra dekorative. Ekspozita "Ndryshe" hapet me datën 11 tetor, në Muzeun Historik Kombëtar dhe do të qëndrojë e hapur deri më datën 20 tetor, 2018. "Ngjyra, kontraste, dritëhije, fushëpamje mbresëlënëse dhe forma e vëllime të modeluara nëpërmjet njollave të tonaliteteve të shtrira thjesht, me plot siguri. Një pikturë, e cila shfaqet si një analogji me "i Macchiaioli" të pikturës italiane midis viteve 1850-1870 të shekullit të XIX. Njolla të cilat në pikturën e Pashk Përvathit kanë revolucionuar me stilin e tij gjininë e peizazhit dhe jo vetëm në pikturën shqiptare. Ai nëpërmjet shtrirjes së fushave të ngjyrave në mënyrë të thjeshtëzuar nxjerr në pah një gjurmë të gjithën vetjake, duke paraqitur me realizëm natyrën, por njëkohësisht e filtron esencën e saj përmes një kodi të ri estetik për pikturën në historiografinë e arteve pamore shqiptare, atë dekorativ", është shprehur për Përvathin, Oltsen Gripshi, studiues.

Sipas Gripshti, qenia fizike e artistit në mënyrë të pavetëdijshme përzien emocione, ndjenja, përjetime dhe kujtime të cilat e ndihmojnë atë në formësimin e stilit të tij krejtësisht vetjak. Të një gjuhe artistike larg çdo ndikimi në realitetin e Realizmit Socialist të djeshëm dhe të konceptualizmit në artin bashkëkohor të sotëm. Kjo, sepse piktori Përvathi natyrën e shikon si "muzën" frymëzuese të peizazheve të tij dhe stinën e vjeshtës si kulminacionin e joshjes ndaj saj... aq sa në vegimet e "Vjeshtës së kuqe", si mbresat e një kohe.

Vetë piktori ka thënë më herët se motivet e ciganëve kanë qenë gjithmonë muza e tij. "Tek unë jam preferencë, sepse përafrohen shumë me konceptin tim, që unë kam për pikturën, me marrëdhënien dekorative në sipërfaqen e tablosë, ç'ka më bukur se tek ciganet, tek veshjet e tyre, nuk e gjen në ndonjë gjë tjetër. Prandaj dhe mua më pëlqejnë dhe dua t'i kem në telajon time. Në këtë ekspozitë është dhe një vizitore e huaj nga Sri Lanka, që ka qenë në studion time, e cila erdhi në Shkodër me një ekip të huaj. Duke dalë jashtë këtyre punimeve që trajtojnë ciganet unë kam trajtuar edhe portretin familjar, si ajo e babait tim, apo dhe të tjerë portrete si 'Bukuroshja e fjetur', etj. Edhe tek tematika e portreteve kam shëtitur", është shprehur Përvathi. Ai ka thënë se asnjëherë nuk është udhëhequr nga parimi se çfarë do të thotë vepra ime dhe çfarë mesazhi përcjell dhe se sa bashkëkohore është situata që bëhet në vendin tonë, madje dhe veprat e kolegëve të mi nuk i kam parë në sensin se çfarë mesazhi përcjellin. "Unë gjithmonë përpiqem që vepra ime të flasë me mjete artistike, në gjuhën e së bukurës dhe për t'i dhënë dhe pak qetësi dhe entuziazëm artdashësit", ka thënë më herët Përvathi, duke vënën në dukje se tregu i artit pamor në Shqipëri është i pakonsoliduar. "Është fakultativ, janë disa njerëz më shumë koleksionistë që kanë filluar të krijojnë koleksionet e tyre, sepse kjo është një gjë e mirë pasi është një ndihmë për artistët dhe një lloj konservimi që i bëhet veprës së mirë, për të mos shtegtuar jashtë kufijve, kjo është ana pozitive", ka vërejtur ai.

## GREZDA: POETIZMI I FIGURËS FEMËRORE MË SHPËTOI NGA REALIZMI SOCIALIST

### *Skulptori vjen me një album të punëve të tij ndër vite*

Pas 50 vitesh pune intensive në skulpturë, Ermir Grezda e ka përmbledhur në një album. Punët më përfaqësuese nudo, portrete dhe kompozime vijnë si dëshmi e punës së tij për brezat. Në një intervistë për "ABC News", ai thotë se poetizmi i figurës femërore më shpëtoi nga socio-realizmi. Të bësh bilancin e 50 viteve krijimtari nuk është lehtë, por gjëja më e rëndësishme është që të jesh në paqe me veten dhe Ermir Grezda edhe pse nuk preferon të analizojnë shumë punët, për një gjë është i vetëdijshëm se ia ka dalë. Skulptori Ermir Grezda thotë për gazeten Leontina Nika se "Interesi edhe i këtyre koleksionistëve është më shumë drejt pikturës dhe skulptura ende është e mbyllur dhe e ngujuar në studiot e secilit artist. E ndjej veten të arrirë dhe atë mision që i kisha vënë vetes e kam plotësuar: niveli i konsiderueshëm i skulpturës sime". Në çdo skulpturë, ai inspirimin e ka marrë nga natyra. Femra e ka joshur në çdo kohë të cilën e ka pasqyruar në dy tematikat. "Dy pjesët më kryesorë janë, tema kushtuar nënës dhe nudot. Tipologjisë së femrës shqiptare që është shumë elegante dhe kjo vjen edhe për shkak të traditës ilire të antikitetit tonë. Sidomos në këto 15 vitet e fundit bukuria shqiptare është shpalosur në formë dhe elegancë", vëren ai. Ermir Grezda thotë se poetizmi i figurës femërore në skulpturë e shpëtoi nga realizmi socialist.

"Në fillim të krijimtarisë fillova me temën "nëna dhe fëmija" në variante të ndryshme dhe përzgjodha atë që mu duk më interesante nga ana kompozicionale. Në mënyrë të pavetëdijshme hyra në poezinë e skulpturës, hyra në jetën e marrëdhënies njerëzore, asaj poezisë që ka njeriu, bukurinë, elegancën. Të gjitha ato që janë pjesë e parqeve kudo në botë. Shpresoj që "Nëna dhe Fëmija" të vendoset në një shesh. Madje edhe "Vallja e Shpatave", është pjesë e Galerisë Kombëtarë dhe është publikuar në revista ndërkombëtare dhe është një nga veprat që përfaqëson traditën. Është pjesë e stilistikës së valles popullore shqiptare".

Tashmë punët me përfaqësuese i ka përmbledhur në një album, si dëshmi për breza. Krijimtaria në skulpturën e Ermir Grezdës bën pjesë në brezin e artistëve të pas viteve '70. Harmonia plastike, silueta elegante, natyraliteti në të cilat është hedhur në skulpturë vepra e tij, shprehin shumë ndjenjë duke u bërë pjesë e jetës emocionale të vetvetes. "I jam përmbajtur artit realist. Realizmi është pa kufi dhe janë të gjitha punë me pikënisje nga natyra. Nudot janë pjesa më artistike, janë një pjesë e jetës njerëzore".

Emocionaliteti i shpërthyer qëndron të ritmi, zhdëverjelltësia dhe ekuilibri brenda plastikës skulptorike të fortë dhe impresioniste. Çdo vepër e tija ka një histori të tërë në vetvete. Grezda vlerëson emocionet që ka jeta, të bukurën, dashurinë plastike, sensivitetin emocionues e të veçantën e shfaqjes në lëvizjet plastike, në shërbim të estetikes emocionuese që kërkon. Portretet dhe figurat e natyrave të ndryshme kompozicionale të imponojnë për një realitet ndryshe në skulpturë. Tek skulptura e Grezdës kombinohet modernia, bashkëkohorja me konceptin emocional plastik në fushën e skulpturës dhe të arsimit artistik, ku u lind në Tiranë në gusht të vitit 1949. Fillimet e tij artistike vijnë nga periudha përgatitore në Liceun Artistik dhe përfundimin me shumë sukses të Akademisë së Arteve Figurative me 1972. Fillimisht Grezda ka punuar për 20 vjet në Galerinë Kombëtare të Arteve në sektorin studimor dhe ciceron arti pranë kësaj Galerie. Karriera e tij artistike fillon me çmimin e parë në konkursin ndërmjet artistëve të rinj. Në krijimtarinë e mëvonshme u mor me skulpturën monumentale në bronz. Grezda ka marrë pjesë në ekspozita kombëtare dhe ndërkombëtare, ku dallohet për gjetjet e reja artistike dhe stilin e tij në krijimtari. Veprat e tij kanë pasur një vlerësim të veçantë në ekspozitat jashtë shtetit.

Opinioni i Ditës

# "Babalja", ku u xhirua filmi, në SHQUP apo në Surrel?

Nga Andi Bushati

*(vijon nga faqja 1)*



… as atë që pretendon Edi Rama, se ai ishte një lojë me aktorë, e luajtur në selinë e PD-së. Me pak fjalë, ai thotë se zëri i vëllait të ministrit të Brendshëm, Agron Xhafajt nuk është i deshifrueshëm për shkak të cilësisë së dobët. Por ai nuk mbështet dot as versionin e mbrojtur nga Prokuroria, Rilindja dhe gazetarët pranë tyre, se rolin e ka luajtur Fredi Alizoti, në këmbim të parave që i janë ofruar nga qarqe pranë PD.

Pra, ajo që na u premtua nga kryeministri me siguri të plotë, se prova shkencore ndërkombëtare që ai arriti ta marrë në më pak se 24 orë, rezultoi një dështim.

E vërteta mbeti në mes. Socialistët sërish do të vazhdojnë të thonë se e gjitha ka qenë një montim dhe demokratët do ia kthejnë se manipulimin e kanë bërë ata.

Në mungesë të një institucioni të besueshëm ndërkombëtar për zbardhjen e ngjarjes, rolin e ndriçimit të saj do ta marrë sërish në dorë Prokuroria shqiptare.

Po, për të kuptuar sa e aftë është ajo ta mbajë të veshur këtë kostum, filmin duhet ta kthejmë një vit më parë.

Atëherë socialistët shpallën se, në kundërshtim me të gjitha ligjet dhe frymën e reformës në drejtësi, kryeprokuroren do ta zgjidhnin me votat e tyre. Opozita ia ktheu se këtë po e bënin për të mbyllur të gjitha çështjet që u digjnin.

Qeveria këmbënguli se kjo prokurore do të qëndronte vetëm një apo dy muaj, nuk do të kishte të drejtë të bënte lëvizje, nuk do të gëzonte kompetenca t'u hiqte dosje vartësve apo t'i transferonte ata. Në fakt, të gjitha këto ndodhën njëra pas tjetrës.

Dhe kësaj prokurorie i takon të zbardhë sot dosjen "Babale-Agron Xhafaj".

Dhe është e lehtë të shikohet se ç'ka bërë.

E la menjëherë Agron Xhafajn të largohej nga vendi sepse nuk i interesonte të hetonte atë. E përqendroi të gjithë hetimin te pista që e shfajësonte Xhafajn, duke përforcuar versionin e një aktori me pagesë? Nuk u thellua në investigim se mos ky aktori me pagesë ishte përpunuar nga ata që ishin të interesuar për ta daravitur skandalin që u plasi në derë. Nuk ngriti pikëpyetje se si i bëhet që ekspertët britanikë të "JP French Associates" nuk japin garanci që ai të jetë zëri i Fredi Alizotit.

Pa përfillur asnjë nga këto dilema, publikut shqiptar do i serviret gjella tashmë e njohur se avionët e drogës janë mushkonja, se Dritan Zagani është trafikant, se Saimir Tahiri nuk i njeh Habilajt, se Xhisiela vetëdigjej me cigare dhe se Taulant Balla nuk ka foto me trafikantë. Ata do të dëgjojnë se dikush ka paguar kunatin e "Babales", Fredi Alizotin, që të bënte rrolin e vëllait të ministrit të Brendshëm, në një plan të mirëmenduar për të rrëzuar qeverinë. Ata do të dëgjojnë se e gjitha ishte një montim. Ata do të dëgjojnë se filmi u luajt dhe u sponsorizua në zyrat e SHQUP-it.

Natyrisht, të gjitha këto edhe mund të jenë të vërteta.

Por, kjo nuk i heq askujt të drejtën të logjikojë nga e kundërta. Përse gjithçka nuk qenka gatuar në vilën e Surrelit? Pse Rama, kur paska qenë i ndërgjegjshëm se një aferë e tillë i rrëzoka qeverinë, të mos ketë manipuluar ai? Pse një njeri që u quajtka aq i korruptuar sa të marrë para nga njëra palë, mos i merrkërka ato edhe nga pala tjetër? Pse ta kenë paguar demokratët Alizotin dhe të mos e kenë paguar socialistët, që të luajë rrolin e një të dëshpëruari që nuk i kanë dhënë 100 mijë eurot e premtuara?

Pra, pse duhet të besojmë se ateljeja e kinostudios qenkësh ngritur në SHQUP dhe jo në Surrel?

Me sa duket, të dyja këto variante do të vazhdojnë të bashkëjetojnë. Dhe për këtë ka vetëm një përgjegjës. Ata që na premtuan një ekspertizë të besueshme ndërkombëtare dhe nuk na e sollën, ata që një vit më parë nuk nguruan ta lyejnë prokurorinë me ngjyrat e tyre.



Opinioni i Ditës

# Komunikimi kundër opozitës i opozitës

Nga Julian Zyla

*(vijon nga faqja 1)*

... opozita kërkon të mos kritikohet opozita, nuk është duke kërkuar që të kritikohet qeveria, por, të kritikohet vetëm qeveria.

Por cili ka qenë komunikimi më i efektshëm kundër opozitës? Ai i opozitës! A ka mundur opozita të bindë se është një nga pjesët e shoqërisë që kërkon me çdo kusht të përmirësojë jetesën e shqiptarëve dhe se ardhja e tyre në pushtet është thjesht mjeti?

Njerëzit më tepër shohin një grup që kërkon me çdo kusht të vijë në pushtet dhe se përmirësimi i kushteve të jetesës së shqiptarëve është thjesht një nga temat. Ose, nuk është as një nga temat, sepse komunikimi i opozitës përmban kryesisht tema abstrakte penale e politike. Njerëzit, edhe kur janë personazhe nismëtarë të ndonjë çështjeje, kthehen jo në shkallë, por në raketë, për të shkuar nëakuza përgjegjësie të drejtpërdrejta për Ramën. Si mund të jetë kjo mënyra për të përmirësuar jetesën e shqiptarëve?

Në çfarë elementësh do të mund të ndahej kjo mjeshtëri në paaftësi e opozitës? (Kush nuk është dakord se është mjeshtëri në paaftësi, pranon se Basha po kërkon vetëm pushtetin, çka mund të diskutohet.)

Së pari, një nga elementët është: opozita nuk përshëndet asnjë vendim të qeverisë. As me nismat për mjedisin nuk është dakord? Të pastrosh Shqipërinë qenka diçka për të cilën nuk ia vlen të bashkohet politika? Si mund të ketë besueshmëri kur e gjen fjalën e përbashkët përpara zgjedhjeve, por jo përpara një aksioni kombëtar për pastrim?

Reagimet pozitive nuk do të ishin vetëm legjitimim i veprimeve të qeverisë, por, mbi të gjitha, legjitimim i vetë opozitës si një grup politik që nuk kritikon për hir të kritikës, por vetëm kur beson se diçka po keqmenaxhohet. Nëse për çdo teshtimë fajin e ka Edi Rama ("Thanks Obama!"), ai që konsumohet nuk është Rama (ose Obama), por pala akuzuese.

A ka faje Rama? E pranon edhe vetë që bën gabime, duke u tërhequr në disa raste. Por padurimi për të arritur te ai për çdo ngjarje, pavarësisht nivelit në të cilin ndodh, tregon vetëm papjekuri nga ana e opozitës.

Së dyti, një tjetër element është perceptimi ndaj opozitës se nuk ka një alternativë qeverisëse ndryshe apo më të mirë për të ofruar. Kjo lidhet si me faktin që është një forcë që ka udhëhequr për dekada, ashtu edhe me elementin e tretë e të fundit, të cilin e përmendëm: faktin që debati i saj nuk qëndron te problemet e njerëzve, por mezi pret të fluturojë te Edi Rama.



Nëse debati opozitar nuk i jep shumë hapësirë problemeve ditore të njerëzve, si mund të shmanget perceptimi se mund të bëhet fjalë për mungesë alternative? Pse duhet t'u interesojnë njerëzve debatet që i interesojnë opozitës, mbushur me emra të përveçëm, por të zbrazët nga problemet e përgjithshme? Ky perceptim bën pa interes përpjekjet e veçanta të opozitës.

Elementi i tretë, i sipërpërmendur, është dedikimi i munguar ndaj problemeve, ndaj njerëzve. Duket sikur ka një padurim për të gjetur rrugë të shkurtra. Shkohet tre ditë nëpër fshatra, durohen historitë e tyre për dy-tre ditë dhe, kur nuk ndërrohet pushteti, "kthehemi te temat e zakonshme".

Imagjinoni këtë padurim ndaj punës së detajuar të qeverisë. Qoftë si ekzekutiv, qoftë si ekzekutuese e disa strategjish komunikimi.

Është thënë e rithënë, që për të krijuar ndjekës një njeri duhet të frymëzojë. Sa frymëzojnë prokurorët, si njerëz të akuzës? Aq frymëzon opozita. Edhe nëse preceptimi i fillimit mund të jetë në favor të tyre për ndonjë çështje, qoftë para se me dy lëvizje të arrihet te akuzat për Edi Ramën, maksimumi që mund të arrijnë janë disa vota më pak për shumicën parlamentare.

Por a janë këto vota për ta? Me gjasa kthehen në abstenime. Do të mjaftonte? Nëse po, është opozita në drejtimin e duhur dhe së shpejti do të vijë në pushtet. Por, me gjasa, opozita pa ndërruar gjeneral apo strategjinë gjenerale do të jetë rruga e shkurtër për fitore radhë të atyre që flasin me njerëzit për ato që shqetësojnë njerëzit.

> Së pari, një nga elementët është: opozita nuk përshëndet asnjë vendim të qeverisë. As me nismat për mjedisin nuk është dakord? Të pastrosh Shqipërinë qenka diçka për të cilën nuk ia vlen të bashkohet politika? Si mund të ketë besueshmëri kur e gjen fjalën e përbashkët përpara zgjedhjeve, por jo përpara një aksioni kombëtar për pastrim?

## HOROSKOPI

### DASHI
Do të ndiheni shumë mirë, teksa do të përjetoni momente të lumtura me njerëzit përreth jush. Bëni kujdes me shëndetin dhe mos neglizhoni asgjë që iu duket e dyshimtë. Nëse detyroni dikë të marrë një vendim të rëndësishëm, ka gjasa të dëmtoni veten tuaj.

### DEMI
Mund të ndiheni shumë të lodhur për shkak të punës së tepërt që keni bërë gjatë këtyre ditëve. Përpiquni të evitoni stresin, pasi do të ndikojë negativisht në gjendjen tuaj psikologjike. Do ta keni shumë të vështirë të merrni vendime gjatë ditës së sotme.

### BINJAKET
Shmangni konfuzionin dhe acarimin, pasi do të përballeni me disa probleme bankare. Në punë, gjërat do të jenë në favorin tuaj. Tregohuni të kujdesshëm kur të komunikoni me disa persona të rëndësishëm. Sot do të kuptoni se dashuria e partnerit tuaj do t'ju shërojë çdo dhimbje në jetë.

### GAFORJA
Miqtë do t'ju prezantojnë me një person të veçantë, që do të ketë shumë ndikim në vendimet tuaja. Ka gjasa të nisni një romancë të re. Nëse do të dilni me miqtë, sot do të kaloni një mbrëmje të paharrueshme.

### LUANI
Edhe pse do të shpenzoni shumë, sërish do të qarkulloni para. Do të shijoni një ditë të këndshme me anëtarët e familjes. Personat që do t'ju afrohen për interes në punë, bëni mirë t'i shmangni. Mbikëqyrja juaj e ashpër do t'ju bëjë të dilni mbi të tjerët.

### VIRGJERESHA
Dita e duhur për të realizuar ato që keni parashikuar, çfarë do t'ju bëjë të ndiheni mjaft mirë. Shmangni investimet afatgjata dhe përpiquni të argëtoheni sa më shumë, duke dalë me miqtë. Partneri/partnerja do të tregohet shumë mbështetës ndaj jush.

### PESHORJA
Duhet të kontrolloni emocionet dhe të largoni frikën sa më shpejt të jetë e mundur, pasi kjo mund të ndikojë negativisht në shëndetin tuaj. Dita e duhur për të komunikuar me disa persona që i takoni shumë rrallë.

### AKREPI
Nëse ndiheni shumë të stresuar, kaloni më shumë kohë me fëmijët tuaj. Përqafimet e ngrohta dhe buzëqeshja e tyre e pafajshme do t'ju lumturojnë pafund. Anëtarët e familjes do të mbështesim pikëpamjet tuaja.

### SHIGJETARI
Ka gjasa të përballeni me disa probleme financiare, por do të dilni thjeshtë prej tyre, pasi do t'ju mbështesin prindërit. Lidhja romantike do t'ju mbushë me shpresë. Nuk është dita e duhur për të udhëtuar.

### BRICJAPI
Do të realizoni një udhëtim që do t'ju lumturojë dhe relaksojë. Përpiquni të mos i ofendoni të tjerët dhe përshtatuni me familjarët. Sot do të kënaqeni pamasë, pasi do të merrni materialet e nevojshme për të përfunduar një projekt të nisur shumë kohë më parë.

### UJORI
Përpiquni të shmangni tendencën për të jetuar momentin dhe për të shpenzuar më shumë seç mundeni. Kërkoni ndjesë për sjelljen e ashpër në dashuri. Përpjekjet për një paraqitje më të mirë do të ndikojnë shumë mirë në gjendjen tuaj.

### PESHQIT
Buzëqeshja është kundërpërgjigja për çdo problem tuajin. Sjellja juaj e pakujdesshme do të shqetësojë prindërit. Do ta keni shumë të vështirë të qëndroni larg të dashurit. Do të kaloni një ditë shumë të këndshme me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

### La Finlandën për Shqipërinë

## Ademi: Ëndrra ime ishte të luaja për vendin tim




Albian Ademi është një nga emrat e rinj që shfaqen në grumbullimin e përfaqësuese shqiptare Shpresa për ndeshjet kundër Spanjës dhe Estonisë. Futbollisti ka spikatur në Finlandë me fanellën e Inter Turku, ku ka shënuar në 3 ndeshjet e fundit radhazi, si dhe me përfaqësueset e moshave të këtij vendi, por tani ka zgjedhur që të veshë fanellën kuqezi. "Kam pasur gjithmonë dëshirë të luaj me Shqipërinë. Kam folur me trajnerin disa herë, kisha dëshirë të vija këtu dhe besoj se Shqipëria është më e mirë për futboll. Dua të luaj për vendin tim. Kombëtarja A? Është e vështirë, do duhet të luaj mirë gjithmonë, të prezantohem mirë me ekipin në Finlandë dhe kombëtaren Shpresa", tha ai në konferencën e djeshme për shtyp. Por sulmuesi është i ndërgjegjshëm se ndeshja ku pritet të bëjë debutimin e tij, nuk do të jetë shumë e thjeshtë. "Atmosfera është e mirë, në kombëtare janë lojtarë të mirë. Po përgatitemi të bëjmë lojën që na kërkon trajneri dhe shpresojmë të jemi mirë në këtë ndeshje. Besoj se do të mbrohemi pak më shumë, duhet të luajmë të mbledhur si ekip, kur të kemi shanset të shënojmë. Do luajmë në kundërsulm dhe shpresojmë të shfrytëzojmë shanset tona",-tha futbollisti 19-vjeçar.



Jeton Selimi

### Italiani "sulmon" mbrojtësin Elseid Hysaj: Një lojtar si ai s'mund të ankohet për skemat

# Panuçi: Kapitenin do e zgjedhin lojtarët!

### *Për trajnerin, Jordania është shumë e vlefshme*

Ndeshja me Jordaninë është një test i rëndësishëm për Kristian Panuçin dhe Kombëtaren kuqezi përpara përballjes së rëndësishme me Izraelin. Në konferencën e fundit për shtyp përpara takimit, tekniku italian sqaron gjendjen e grupit të lojtarëve dhe arsyet se përse zgjodhi Jordaninë në këtë miqësore. "Kemi disa lojtarë që duhet të kenë më shumë minuta si Grezda, Mavraj, Gjimshitit, sepse në klubet e tyre kanë luajtur pak kohët e fundit. Grupi ka punuar mirë dhe ka shpirtin e duhur për të bërë një ndeshje të mirë, sepse është një ndeshje kombëtareje. Jordania është zgjedhur duke parë renditjen e saj, një kundërshtar për të përgatitur ndeshjen me Izraelin në Ligën e Kombeve".




Opinioni sportiv ka pasur shumë dilema në lidhje me grumbullimet kuqezi të ish-lojtarit të Milanit, pasi ai ka snobuar kategorinë superior, por edhe për këtë, Panuçi e ka një përgjigje. "Po shohim shumë lojtarë dhe kur ka qenë rasti për të marrë një të ri, si Vrioni, për shembull, e kam marrë. Kështu bëra edhe me Uzunin tani. Dyert janë të hapura për të gjithë".

Pas ndeshjes me Skocinë, Elseid Hysaj deklaroi hapur se nuk arriti ta kuptojë ndryshimin e skemës së lojës në pjesën e dytë, çka turbulloi jo pak ujërat në kampin kuqezi, por Kristian Panuçi ka kaluar në kundërsulm menjëherë. "Një lojtar që luan në Champions, nuk e ka problem skemën. Nuk ndryshon gjë, sepse nuk është problem skeme. Për Izraelin do të mendojmë pasi të shikojmë edhe ndeshjen e tij me Skocinë. Tani të mendojmë për Jordaninë".

Tjetër çështje e ndjeshme ka qenë ajo lidhur me shirtin e kapitenit, shirit që ka ndryshuar shumë duar me Panuçin në stol. Italiani e ka sqaruar edhe këtë temë, duke deklaruar se zgjedhjen e kapitenit të Shqipërisë ua ka lënë lojtarëve në dorë. Dua të sqaroj çështjen e kapitenit, duke parë që po bëhej një çështje ndërkombëtare. Unë kam folur me presidentin dhe me lojtarët dhe kemi rënë dakord që ata të zgjedhin kapitenin dhe dy zëvendëskapitenë. Tani mos filloni t'i merrnin lojtarët në telefon. Nuk është e thënë që kapiteni të luajë patjetër. Do ta shikoni kapitenin nesër, nëse luan. Menduam se kështu është më mirë".



### Duka: Ka grupime kundër Panuçit, por nuk janë të organizuar

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, nëpërmjet një prononcimi për "TV Klan" ka reaguar në lidhje me deklaratën e trajnerit Kristian Panuçi në konferencën për shtyp ku deklaroi se ka një komplot në Kombëtare dhe dikush po përpunon lojtarët për të thënë që janë të pakënaqur. Në lidhje me këtë çështje, Duka ka treguar se ka grupime kundër, por që nuk janë të organizuar. Kreu i FSHF-së nuk pranoi te jepte detaje specifike. "Në fakt ka grupime, por nuk është se janë të organizuar. Sakrifikojnë veten për t'u treguar të rëndësishëm. Sulm i orkestruar, i dirigjuar kundër një njeriu të vetëm nuk ekziston",-u shpreh shkurtimisht Duka.

### Mbrojtësi pritet ta nisë nga minuta e parë

## Lila: Kapiteni nuk është mbi të tjerët, shpresoj që "zjarri" brenda meje të mos shuhet

Andi Lila do të jetë kapiteni kuqezi në miqësoren e sotme kundër Jordanisë dhe sipas të gjitha gjasave do të jetë titullar nga minuta e parë. Kavajasi është lojtari më i vjetër në këtë grumbullim, pasi është pjesë e Kombëtares së Shqipërisë që prej vitit 2007, por është entuziast si të ishte hera e parë.

**U bë viti 11 që je me Kombëtaren, a luajmë ndeshje të rëndësishme?**

Jam që në 2007 me Kombëtaren dhe kur sa herë vjen ftesa për Kombëtare nuk më zë gjumi. Është gjëja më e bukur që mund të të ndodhi. Shpresoj që ky zjarr të vazhdoj edhe më tutje.

**Çfarë duhet të bëjmë për të fituar përsëri në Izrael si 2 vjet më parë?**

Të jem i sinqertë forca e ekipit tonë është grupi, dhe nëse ne luajmë si grup ndeshja do të fliste njësoj. Shpresoj të jetë ndeshje e mirë dhe të bëjmë atë që bëmë 2 vjet më parë. Ne kemi pasur gjithmonë shpirt gare. Megjithatë përpara kësaj kemi ndeshjen me Jordaninë, pastaj të shohim me Izraelin.

**Sa ndihet në skuadër ndërrimi i shiritit të kapitenit?**

Shumë respekt për të gjithë kapitenët. Në Kombëtare kapiteni nuk është mbi të tjerët. Këtu janë të gjithë njësoj. Shpresoj që të gjithë të bëjnë punën në fushë. Nuk duhet të ketë diferenca në ekipin kombëtar.

**Si iu duken lojtarët që vijnë të bëhen pjesë e grupit dhe si i ndihmoni ju?**

Të them të drejtën, çdo i ri që vjen, nuk ndjen asnjë lloj presioni. Ne u kemi qenë afër. Fundja ne jemi shqiptarë dhe duam të bëjmë sa më mirë në fushë. Ekipi kombëtar ka një të ardhme shumë të ndritur me të rinjtë që kanë ardhur.

### Formacioni kundër Jordanisë

## Mavraj projektohet titullar, Uzuni e Gavazaj në balotazh

Shqipëria do të luajë sot në "Elbasan Arena", miqësoren me Jordaninë, vetëm 4 ditë para se të përballet për ndeshjen e Ligës së Kombeve, ndaj Izraelit në transfertë. Një test miqësor, për të parë gjendjen e grupit përballë një ndeshje vendimtare për fatet në turneun e Ligës së Kombeve. Siç bëhet me dije, formacioni për nesër pritet të jetë 4-2-3-1. Strakosha duket i pazëvendësueshëm mes dy shtyllave. Më pas, nga e djathta Hysaj, ndërsa në të majtë Lenjani, por një opsion është edhe Binaku i Malmos. Qendra e mbrojtjes përbëhet nga Mavraj e Gjimshiti, të dy pa shumë minuta në këmbë. Basha dhe Lila do të bëjnë lidhjen e mbrojtjes, me pjesën para të ekipit, ndërsa në linjën ofensive, priten Grezda, Memushaj e Gavazaj, ose në vendin e ish-mesfushorit të Skënderbeut, Myrto Uzuni, i thirrur për herë të parë në Kombëtare. Balotazhin për pozicionin e vetëm në sulm, mes Balajt e Manajt, mesa duket e ka fituar shkodrani. Gjithsesi, ditën e nesërme mund të mësohen më shumë të reja nga 11-shja e italianit.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al